

# Robert Goro

TAKOHEMI  
PASDITE



BIBLIOTEK  
86-32  
896

8SH-32  
G 66

ROBERT GORO

TAKOHEMI  
PASDITE

tregime dhe novelë



SHTËPIA BOTUESE  
«NAIM FRASHËRI»

## NJERIU QË KISHTE HUMBUR KËNGËN

E quanin Pan Kaoni. Këndonte aq ëmbël dhe i binte aq bukur fyellit, a thua se qe ngritur nga varri vetë Pani i lashtësisë. Kur këndonte ai, qielli ulej më poshtë, dielli afrohej edhe më, që të merrte ngrohtësi nga zëri i tij, deti, i magjepsur, e ndalte edhe bërtitjen, edhe mërmërimën, që të mos i pengonte njerëzit, zogjtë e pemët të dëgjonin këngën e djaloshit.

Vetëm në një gjë ndryshonte nga Pani i lashtë Pani ynë: ishte shumë i bukur. Natyra kishte mbledhur e i kishte dhënë fytyrës e trupit të tij tërë bukuritë e dheut, të detit, qiellit e nëntokës. Rrobat e arnuara, përherë të pastra, ia nxirrnin edhe më shumë në pah bukurinë. Ky ishte Pan Kaoni. Fukara te zoti! Por ishte dhe i vetmi gëzim, (sado i paktë), në jetën e hidhur të banorëve mjeranë të visit të tij dhe viseve të tjera përreth.

Ulej mbi një gur buzë detit dhe ia merrte këngës. I binte tejendanë asaj çikë tokë që ki-

shte dhe ia merrte këngës. Me këngë shkonte nga dhimbja në dhimbje. Vuante për të gjithë, dhe të gjithëve ua lehtësonte vuajtjet me këngën e tij:

*Dritëfikuri për jetë  
ndez në këng' qirin' e vet...*

Kjo ishte kryekënga e tij, ku çdo njeri mbështeste buzën e zhuritur për pak lumturi, sikur atje të buronte Kroji i Jetës. Vërtet, kënga e tij ishte Kroji i Jetës.

\* \* \*

Një ditë prej ditësh kaloi atypari një njeri. Veshja plot salltanet, kuajt dhe trimat që e shoqëronin, e tregonin qartë se ai qe një pasanik i kamur bukur mirë.

Ndanë arës së Panit i mbajti këmbët pasaniku, u magjeps edhe ai nga kënga. Priti sa mbaroi, pastaj kërceu nga kali:

— Të falem, o njeri i mirë! — i tha. — Kënga jote qenka ilaç edhe më i mirë se ky ajër i pastër i detit, jetën ta bën më të bukur!

— I lumë qofsh, or mik! — iu përgjigj Panni me dorë në zemër. — Prandaj dhe unë këndo, që t'ia ndiej një fije bukurinë kësaj jete:

*Dritëfikuri për jetë...*

Kishte nisur të këndonte në vakt të drekës dhe vetëm kur dielli po shtrihej ngadalë në shtrojat e veta prej ujërash llamburitëse, kalim-tari u përmend:

— Të lumtë goja! Vetëm të mira paç! Më vjen shumë keq që po iki, por duhej të shkoj pa-tjetër. Vetëm, pa dashur të të fyej, kërkuj të të them diçka. Vërtet jetën e zbukuron kënga, por jetës i duhet edhe diçka tjetër, banale e megjithatë e domosdoshme: paraja. Për fat të keq, gjithçka nis e mbaron te këto monedha të urry-era. Në vend që të shndritin në qafat e vajzave e të nënave këta florinj të mjerë lapërdhosen nga duart e njërit e të tjetrit, bile edhe nga duart e mia...

Heshti për një çast, soditi trandafilat e përgjakur në qiell dhe pastaj, duke e parë Panin drejt në sy, vazhdoi:

— Të thashë prapë, nuk dua të ma marrësh për keq. Dëshiroj, si mik, të të fal ca para.

Dhe i la në prehër një grusht verdhush-kash, që, nën dritën e mugëtirës, ngjanin si manushaqe të vyshkura. Pani u hutua, i iku zëri dhe as i ra ndër mend t'i thoshte «falemnderit» e ta pyeste për emrin të panjohurin që u zhduk tej monopatit.

I rrotulloi sytë nëpër terr, si kunadhja. E zuri frika se mos e kishte parë kush. Zemra nisi t'i rrihte fort, a thua se në kraharor kishte dy gurë mulliri që vërtiteshin si kuaj të hazdisur.

Ngriti rrogzin mbi të cilin flinte dhe gërmoi në dhé. Pastaj i mbështolli florinjte me një shami mëndafshi, që s'mbante mend se kush ia kishte dhuruar, dhe i mbuloi. Aq florinj, s'kish guxuar, t'i shihte as në ëndërr. Ishin një pasuri e tërë, me të cilën mund të blinte gjithë fshatin. Ose mund të ikte diku, në ndonjë qytet, e ta niste jetën nga e para.

Ngriu. U bë sy e veshë. Iu bë se dëgjoi hapa jashtë kasolles së tij. U ngrit, mori sëpatën, ngjiti veshin te dera. Mbajti frymën. Asgjë. Doli vjedhurazi dhe mori një bigaçe ulliri. E mbështeti pas derës. U mbështet edhe vetë në të. Kështu e gjeti dita.

Bashkëfshatarët kaluan të gjithë andej për ta pyetur se si qe gdhirë. Ishin bërë merak, ngaqë mbrëmë s'i kishin dëgjuar këngët e tij.

«Hëm!, Ata gënjejnë! Ata të gjithë e dinë historinë e verdhushkave dhe tani kalojnë këndej vetëm e vetëm për të hetuar e për të thurur marifetet se si do më vrasin e më vjedhin, paratë!»

Lloj-lloj mendimesh, që s'i kishte ndier kurrë më parë, nisën ta torturonin. Befas u ndie shumë i pafuqishëm e i vetmuar, si një lebroz. Vetëm këmbora i mungonte. Një hiç qenka njeriu i shkretë, një krimb, të cilin mund ta dërrmojë me këmbë i pari kalimtar që do ta ndeshë udhës...

Për ta hequr mendjen nga sëkëllditë e liga, nisi të këndonte. Po menjëherë ndaloi. Duke kënduar, s'do të mundte ta ndiente hajdutin, që i rrinte pas dere dhe priste çastin e volitshëm që t'ia fuste me sëpatë kokës.

Vetëm tri ditë kishin kaluar. Pani që ligur e fishkur sa për tridhjetë vjet. Kënga i dilte nga zemra dhe përpiqej të ngjitej lart, por ai e shtynte poshtë me një forcë e këmbëngulje prej të marri. Nga e gjithë kjo, vetja i ngjante si një zgavër lisi përzhitur rrufesh. Ndihej pa zemër, pa stomak, pa mushkëri. Një koshere bletësh që ka brenda vetëm hojet e zbrazëta.

\*  
\*      \*

Mezi e shtyu gjer në të gdhirë. Natën bëhen vetëm punët e liga. Të mirat bëhen ditën, madje herët në mëngjes, kur drita është ende e virgjër.

Kishte dy orë që po ecte. E njihte me pëllëmbë çdo skërkë e gur dhe gjithçka e kishte menduar bukur e mirë për tërë natën.

Gremina ishte nja 80 metra e lartë. Në mes të saj, 30 metra më poshtë, jeshilonte një lëndinë e vockël, ku nuk mund të zbriste dot as djalli as perëndia.

I peshoi për pak florinj të në dorë dhe pas-

taj, pa u menduar fare, i lëshoi poshtë. As që i hodhi sytë andej.

Këngën po e ndiente diku në stomak, si një farëz fëmije, që rritej e rritej ngadalë. Këmbëngulëse, shpërthyesë, e vendosur me çmos për të dalë në dritë.

E pa që atje tej lumturinë që po i rikthehej. Gjithçka befas ishte shndërruar dhe kishte rimarrë trajtat e para. Pan Kaoni ishte ringjallur dhe kjo s'ngjante aspak me ringjalljen e Krishtit.

Qielli u ul edhe më poshtë, dielli u afrua edhe më. Deti heshti. Njerëzit morën frymë të lehtësuar. Kur ishte mirë e shëndoshë Pan Kaoni, ata ndiheshin edhe më mirë.

*Qoftë mallkuar paraja,  
se më ndau nga sevdaja!*



## KUSH I NGJALL TË VDEKURIT

Në mes të natës, kur njerëzit bënin gjumin e perëndisë, nga ana juglindore e fshatit, aty ku qenë varrezat, erdhi një tollovi e padëgjuar tjetër herë. Ca tinguj të prerë, që më tepër ngjnin me fishkëllima murlani, por që gjithsesi s'qenë të tilla, sepse kohëzgjatja e zërit të tyre s'kalonte çerek minute; ca zhurma sikur lugetërit po ziheshin me luftagurash në mes tyre; ca britma si kuisje gazmore. Të gjitha këto qenë mjaft për t'i ngritur njerëzit nga shtrojat. I tërë fshati u zgjua i tromaksur dhe, me fytyrat rrasur pas xhamave e frëngjive, priste gjakngrirë fundin e botës.

Kjo zgjati gati një orë. Pastaj qetësia që u ndeh në varrezat ua shkyçi gojët njerëzve, të cilët nisën t'i turrnin plot pasion hamendjet e tyre. Të nesërmen Odise Bisha, më i çartuari e më sypatremburi i fshatit, (i cili e ruante këtë mbiemër qysh në kohën e hajdutllëkut, në ato vite të arta kur u fuste tmerrin katër krahina-

ve të tëra dhe pastaj kishte hequr dorë papritur e pa dhënë asnjë shpegim), shkoi andej nga varrezat. Siç tha kur u kthye, pllakat mbi varret dhe sopet e dheut, (në qivuret e më fukarenjve), patën lëvizur si nga një tërmet. Fshatarët qenë aq të gjezdisur, sa të mos t'u zinin besë broçkullave të tilla. (Në fshat do të ndihej edhe një tërmet nga Firifistuni, e jo më nga 500 metra larg.) Mirëpo, kur kjo gjë u përsërit prapë natën tjetër, ata nisën të vritnin mendjen se ku ia patën bërë me hile zotit, që po i torturonte në këtë mënyrë.

Dhe, duke u gdhirë nata e tretë, ata vendosën që gjynaheve ndaj zotit t'u shtonin edhe një tjetër: vunë Odise Bishën tok me dy të tjerë që të përgjonin.

Kur ra muzgu, ata morën udhën për në varreza. Një mijë e ca palë sy i ndiqnin me ankth, kurse Mino Profeti, që merrej me astrologji, i qetësoi të tërë, duke u thënë se zodiaku i Odisesë, — ai kishte lindur më 17 nëntor, — për këtë javë premtonte mbarësi.

Por ajo natë u shndërrua në tragjedi. Nga të tre u kthye vetëm një: Pirro Ditëgjati, pa dëshmitë e të cilit, që kaluan gojë më gojë e brez pas brezi, ky tregim nuk do të ishte shkruar asnjëherë.

Të tre trimat qenë strukur rrëzë varreve dhe me armët në duar i lëviznin sytë nëpër terr, si maçokët. Më pas, kur kishte dalë një çikëz hënë, ata s'e patën hiç vështirë të shikonin pë-

rreth. Ca nga ankthi, ca nga mpirja e ca nga duhma e vdekjes, që vinte prej nëndheut, po e humbnin durimin. Po fati i kishte dëgjuar dhe pas pak ata u shtangën nga habia. Prej natës po dilte, duke sjellë një iluzion drite me vete, Sosja, vajza e nëntë e Lekë Gjokëxhanit, më e bukura mes tërë të bukurave të vilajetit, ajo që i bënte edhe hënën edhe diellin të ulnin kokën para nurit e hijeshisë së saj. E përbuzur nga prindërit, (qysh kur që në duart e së ëmës lehonë fati i saj ishte parathënë pikërisht nga emri që i kishin vënë), e përçmuar nga bashkëfshatarët, (për shkak të leckave të lerosura, që prindërit ia kishin hedhur përsipër në vend të teshave), ajo hodhi shtat e u femërua papritur, pa shkuar as trembëdhjetë vjeç e gjysmë. Mirëpo, duke ndier gjer në palcë përbuzjen dhe përçmimin, si dhe interesimin e lig që nisën të tregonin për të disa nga meshkujt e fshatit, ajo u tërhoq e u mbyll në vetminë e vet dhe s'donte të shikonte askënd me sytë e shkruar, të bukur gjer në trishtim. Duke mos gjetur asnjë gram mirësi ndër të gjallët, ajo nisi të kërkonte mirësinë dhe ngushëllimin të të vdekurit. Të paktën ata s'do t'i silleshin me përbuzje, ashtu sikundër bënin të gjallët, të cilët i flisnin me vështrime dhe asnjëherë me gojë. Për prindërit, motrat e gjithë bashkëfshatarët, ajo ishte shumë e bukur, kështu që asnjërit s'i bënte zemra t'i fliste ashpër; por ishte dhe shumë e luajtur nga trutë, kështu që askujt s'ia mbante t'i fliste normalisht.

Sosja, pra, erdhi, hyri pa u ndier në varrezat dhe pikërisht atëherë nisi ajo tollovia e madhe e tri netve të tjera. Pllakat e varreve kërcitën e u hapën vrulltas dhe nga gropat nisën të dilnin me radhë, duke shkundur dheun prej trupit, ata robë që tërë fshati, edhe tre trimat tanë i dinin të vdekur e të tretur. Por jo, ata qenë më të gjallë dhe se të gjallët vetë; të shëndetshëm, veshur e mbathur për së mbari. Hidheshin të tërë rreth Soses, kërcenin me të, flisnin me ata tingujt e pakuptueshëm, si fishkëllima mur-lani, e merreshin vesh për bukuri të zotit në mes tyre.

Odiseja mbështeti pushkën në sup e mor shenjë për të qëlluar, mirëpo shoku që rrinte pranë tij u përpoq t'ia largonte, (ku mund të vritet një bukuri e tillë! kishte psherëtirë), dhe pushka që u plasi në duar i la të dy top në vend. Vetëm Pirro Ditëgjati nuk e humbi toruan. Për të qe ai vetë Odiseu i Homerit, s'do të lidhe pas direktut që të mos dëgjonte zërin e sirenavë. Pirro Ditëgjati vuante nga ajo sëmundje e çuditshme e gjinekofobisë. Ai kështu edhe vdiq, i pamartuar. Dhe kurrë në jetën e vet nuk ia drithëroi zemrën apo trupin një femër. Pirroja, pra, mori shenjë e qëlloi. Atëherë ngjau ajo çudia që edhe sot e kësaj dite nuk e ka shpjeguar dot askush.

Aty ku ra Sosja, u hap një çast një hon madh, që rrezatonte një dritë verbuese; dy-truparisa u shkulën me zhurmë e me rrënjë dhe

ikën me rrapëllimë pas saj; drita u fik siç fiket vetëtimë. Të vdekurit u fufën në varret e tyre dhe që andej nisën të dilnin ca rënkime të mbytura, që ishin tejet njerëzore dhe të këputnin shpirtin.

Të nesërmen në mëngjes, gjithë frikë e tmerr për sakrilegjin e kryer, aty shkoi tërë fshati. Honi nxinte si goja e qoftëlargut. Në buzë të tij kishte ngecur martina e shkalafitur e Odisesë, kurse pak më tej, në një kaçubë trandafili, ndritnin ca fije mëndafshi të bardhë, çjerre nga të linjtat e Soses.

Fshati mori frymë i lehtësuar. Po natën, nga varrezat erdhi përsëri një angullimë mjerane, një vajtim që s'kishte zot ta pushonte. Ditë, muaj e vite me radhë vazhdoi kjo gjë. U ndezën qirinj, u temjanos varreza disa herë, u bënë edhe tri mesha në kishë. S'fituan asgjë, vetëm humbën gjumin.

Dikush tha se ishte shpirti i Soses që angullinte kështu. Atëherë, për ta qetësuar, i ngritën një këngë, — një këngë që drithëron edhe shkëmbinjtë, — ku i luten të mos shkojë nëpër varre.

Kanë kaluar vite e shekuj që atëherë. Ana juglindore e fshatit gjithmonë vajton. Si në dimër, si në verë, aty natën është njëlloj. Por askush nuk shqetësohet më, sepse të gjithë e dinë. Ulërijnë nga marazi të vdekurit, ata që nuk mund të ringjallen më, për arsyen e thjeshtë se nuk u shkon nëpër varre Sose Gjokëxhani...

## VARRI

Kur mora vesh se Labo Paluri vdiq, nuk u habita aspak. Jo ngaqë kishte mbërritur në atë moshë, kur sinori në mes vdekjes e jetës është shuar fare, pra 90 e kusur vjeç, po se kishte gati gjysmë shekulli që ia kishte dhënë pasaportën vdekjes. Vitet shkonin e vinin, njerëzit po ashtu; djemtë e tij ishin ndarë herët nga kjo botë, shokëve të tij të fëminisë u kishte mbirë bari prej kohësh; vetëm ai qëndronte i paepur, si një nishan që i rri njeriut në fytyrë, qysh kur lind.

\*

\*

\*

Historinë e tij ndoshta s'do ta mësoja kurrë. Por, kur vajta për herë të dytë në atë fshat, u takova me poetin popullor Lefter Ndreu. Bashkë me të shkova në varreza, ku bënte gjumin e përjetshëm djali i tij katërvjeçar. Ishte një varr i thjeshtë, rrethuar me lule që s'vyshkeshin

asnjëherë, sepse poeti, (baba i pesë fëmijëve, me një ekonomi që, kuptohet, s'ishte kushedi se çfarë), shkonte përditë aty dhe kujdesej për to.

Meqë plumbi do plumb, edhe trishtimi po trishtim kërkon. Nisëm të baritnim nëpër varret e bukura, shkelnim mbi barin që vinte erë grua dhe zërat tanë të ulët trazoheshin me fëshfërimën gati abstrakte të qiparisave. Fshati kishte qenë i varfër, por të vdekurve ua bënte nderet tamam, sepse, dihet, kush nuk ka respekt për të vdekurit, nuk mund të ketë as për të gjallët, madje as për veten e vet.

Mes gjithë atyre blloqeve prej çimentoje të bardhë apo të zakonshme, të binte në sy dhe të imponohej përnjëherë një varr i madh, prej mermeri me rrëmba të kuq, rrethuar me ca kangjella elegante hekuri, lyer me varak të verdhë. Në krye, me shkronja të mëdha e të arta, shkruhej: **LABO PALURI**. Ky varr duhej t'u kishte kështu qimet e kokës njerëzve të të ndjerit.

— Ç'ka qenë ky? — pyeta Lefterin.

— Eh, — nënqeshi ai, — gjallë është akoma!

— Ou, e paska bërë gati varrin qysh tani?!

— Që 40 e ca vjet më parë. Pas çdo varrimi që bëhet në fshat, ai vjen e rri pikërisht këtu dhe mua më ngjan se thotë: «Nuk zbres poshtë, pa ju përcjellë të gjithë ju më parë».

— Ç'ka qenë ky njeri? — ngula këmbë unë.

— Tregtar. Më saktë, një dyqanxhi, i thjeshtë. Ndenji nja dhjetë vjet në kurbet, në Korfuz dhe u kthye që andej me pare të ma-

dhe, tre vjet para Luftës. Pasi i martoi të dy djemtë, bëri varrin. Ti e di, ne kemi qenë të këputur. Mjaftonte një sop me dhé e një gur të kryet. Laboja bëri të parin varr dhe për shumë kohë që i vetmi. Varrin ai e kishte sjellë me vete, në Selanik e kishte blerë. Kur mbaroi Lufta, (në kohë të Reformës duhet të ketë qenë, se edhe unë vetë kam qenë shumë i vogël atëherë), ai se nga gjeti tre ustallarë gollobordas. I mbajti një vit të tërë, me hak pune, me fjetje, me të ngrënë e me të pirë. Ndërtoi shtëpi të re, atë atje, majë kodrës. Djemtë e martuar i la tek e vjetra. Fshati kujtonte se varrin ai ia ndërtoi gruas, që që vrrarë nga një plumb qorr në Luftën Italo-Greke. Po kur panë emrin e tij, të shkruar me shkronja ari, e kuptuan se ai kishte rrjedhur. Ndonëse s'kishte bërë as kaq për fshatin të tërë e mëshironin për fatkeqësinë e tij. Nuk thonë [kot: «Mos mbetsh në pleqëri pa grua!»]. Mirëpo mëshira nuk bashkëjeton dot me fodullëkun. Nisën ta shihnin me tjetër sy e t'i përgjigjeshin me të njëjtën monedhë krenarisë së tij të sëmurë. Që atëherë, në dasma nuk e fton më asnjeri, në morte rri në një cep edhe kur thotë ndonjë fjalë, njerëzit vazhdojnë muhabetin, pa ia vënë veshin. I vetmi që i rri pranë është klubxhiu i fshatit. Sepse Laboja e paguan teken e rakisë sa një dopio. Ja, i tillë tip është. Pardje u kthye nga Tirana, dy javë kishte fjetur e ngrënë te pesëmbëdhjetëkatëshi.




I pari në fshat, ai bleu televizor; tani ka dy, edhe një me ngjyra. Bleu një radiomagnetofon 120 mijë lekë të vjetra. Nipat e mbesat nuk i qasi një herë në shtëpi. Dy prej tyre mbaruan universitetin dhe hiqte nga goja e ëma për t'i mbajtur. Ja, ky është Labo Paluri, shëmtimi i fshatit tonë...

\*

\*

\*

Ai vërtet e prishte paren pa hesap, por nuk lejonte as qindarkën t'i shkante kot. Prandaj, atë ditë që do të ikte në Pogradec, pasi piu kafen te klubi buzë detit në Himarë dhe u nis për në agjenci, ndaloi për pak në mes të rrugës. Frynte një erë e tërbuar, a thua se qiellin e kishte kapur kriza e skizofrenisë. Kusurin e dhjetë lekëve që pagoi kafen, e kishte futur në xhep. Aty nuk qenë të sigurt të 9 lekët. Nga xhepi i brendshëm i xhakëtës nxori portofolin e fryrë dhe bëri t'i fuste aty parat e vogla. Për dreq, era ia rrëmbeu një pesëlekëshe dhe ia degdisi tutje. Ai rendi, e arriti dhe u përkul për ta marrë, mirëpo kartëmonedha, si të qe duke u tallur pa pikë turpi, kërceu më tej. «O e marr, o s'i them vetes burrë!», u betua ai dhe nisi të vraponte sa andej-këndej, gjersa u fut nëpër rërën e imët të plazhit të shkretuar. Sytë i kishte të fortë, në trup nuk



kishte provuar ende asnjë sëmundje. Monedha, si një shejtan i vockël, hidhej e përdridhej e nuk i humbte nga sytë.

Këpucët iu mbushën me rërë, shiu që nisi me zulmë i rrëshqiti përmes qafës, në të gjithë trupin, si një gjarpër, por ai s'ndiente gjë. Ai ndiqte vallen marramendëse të monedhës, që po rritej e madhe sa deti në sytë e tij.

Prandaj, kur u fut në ujë, ai u qetësua disi. Duke u lagur, monedha do të ngjitej pas syprinës së detit e ai do ta kishte më të lehtë për ta mbërthyer. Po deti ishte si një krevat i shprishur pas një gjumi me ëndrra të këqija. Palletja iu rëndua nga uji, por ai i jepte kurajë vetes. Ishte kënaqësi dhe krenari që ky rrap shekullor po e sfidonte hapur detin dhe tërbimin e tij. Duke menduar këto, nuk e ndjeu në kohë se krahët iu mpinë dhe kërkonin përpjekje mbinjerëzore për t'u lëvizur. U tmerrua, sepse monedha i humbi nga sytë. Arsyja që fare e thjeshtë: ai po zhytej poshtë e më poshtë në honin dantesk të detit, kurse monedha, ngaqë që lagur, ndoshta ishte ngjitur pas syprinës së ujit të turbulluar. . .

Njerëzit thonë se ai u mbyt për një 5 lehtë. Por unë besoj se ai do të kishte shkuar drejt vdekjes edhe për çfarëdolloj arsyeje tjetër, edhe më të mjerë, sepse varrin, varrin e kishte të kamur e të fismël!

## PROVA E PAFAJËSISË

Në ato vite, që u ka shkuar vakti prej kohësh, Kolë Nashoja gëzonte famë të madhe në tërë Bregdetin. Ishte i fuqishëm si një peshkaqen dhe i zgjuar e i shkathët si një peshk shtizë.

Që fëmijë, sapo kishte mbushur të 14-at, e ndau mendjen: Bukën e gojës do ta nxirrte ndershmërisht, paçka se me qeverinë do t'i mbante qetë përherë të mprehur. Sepse rruga që ai zgjodhi për të jetuar, ishte peshkimi me dinamit. I ati pati punuar ca kohë minator në Sent-Etien dhe, kur qe kthyer në atdhe, kishte kaluar nëpër doganat e ndryshme edhe një sasi të mirë eksplozivi. Vendi qe pëllëmbë e gur dhe me minat, gjithsesi, do të hapte një dynym tokë, ku të mbillte e të kornte.

Kola, duke parë të atin tek i bukoste me dinamit vrimat nëpër gurë, kishte marrë një grusht nga tallashi i çuditshëm. Ishte kureshtar të shihte se si digjej ai. Pastaj i qe kthyer mendja. Pa ia ndarë sytë të atit, që po gatiste

minat, kishte rrëmbyer edhe një kapsollë e një copë fitil.

Kishte rendur në Filikur, aty ku as sytë e djallit nuk të kapin dot. Kishte bërë një kaush prej letre dhe më në fund e kishte gatitur edhe ai «bumjen». I dha zjarr me një eshkë dhe në çast e flaku brenda në ujë. U struk pas një guri dhe po priste të ngjante hataja. Dhe hataja ngjau vërtet, e pas saj edhe mrekullia. Një shtyllë e madhe uji u ngjit përpjetë me zhurmë shurdhuese; pas pak vendi aty u zbardh dhe më në fund nisën të ndritnin në diell qefujt e vrarë. Ishte diçka e pabesueshme, një lojë dritash të arta që të merrte sytë. U krodh në ujë e nisi të hidhte në breg peshqit e vrarë. Mirëpo, sa më shumë nxirrte, aq më shumë shtoheshin ata në det.

Kjo ishte një punë për së mbari, të cilën Kola do ta vazhdonte për shumë e shumë vjet.

\*

\*

\*

Dikur, tanimë ishte burrë 30-vjeçar, baba i tre fëmijëve, e mbërthyen. Komandanti i xhandarmërisë i nënprefekturës ia kishte bërë benë. Disa herë i kishte zënë pusi Kolës, po zogu, si me magji, i kishte fluturuar dorë për dorë. Kola përdorte një marifet: Kur kthehej nga gjyëtia, mushkën e ngarkuar me peshk e niste për-

para, ajo ecte rrëzës e rrëzës, nëpër ca kodra e përrenj, e soste vetë në shtëpinë e të zot. Kurse Kola i binte mes për mes fshatit, me duart në xhepa, duke fshirë çdo dyshim.

Nuk thonë kot, «Tahmaja e madhe e ha të zonë». Kola atë ditë e ngarkoi mushkën sa s'mbante më dhe, ngaqë i vinte keq ta linte peshkun e mbetur aty të kalbej në zall, e mbushi edhe një thes të madh dhe e hodhi mbi shpinë. S'kishte bërë as 200 hapa, derëziu, kur mbinë nga dheu komandanti me tre xhandarë, të dërsirë sikur i patën nxjerrë nga deti me gjithë rroba.

— E, more! — i thirri komandanti. — T'u mbush mendja që nuk i shpëton dot Xhevdet Sahanit, hë? Marrsh përpara, se ke kaq vjet që ma ke sjellë shpirtin në majë të hundës!

Kola nuk u ndie fare, po nga marazi u kërrus edhe më nën peshën e thesit.

\*

\*

\*

Burgu i nënprefekturës nuk ishte tjetër veçse një dhomëz e errët në tavernën e hotelit trekatësh. Ishte pasdite dhe taverna qe një strofull e mirë për ata që nuk i bënë dot ballë vapës, si dhe tundimit për të kthyer një gotë e për të marrë vesh haberet e ditës.

Kola mendoi se disa hapa më larg po merrej

edhe ai nëpër gojë dhe sedra burrërore iu lëndua. Kushedi se ç'thashetheme bënin matanë me emrin e tij, kushedi sa e tallnin, kushedi se sa veta po i skërmitnin dhëmbët nga kënaqësia.

Në atë çast jashtë portës u dëgjuan ca hapa. Kolës i regëtiu diçka në mendje, ndaj u hodh nga cepi ku qe mbështetur dhe e futi kokën në kuadratin e frëngjisë së vogël. Ramo Dhimedhaku, shërbëtori i hotelit, po dilte nga një derë me ca shishe vere nëpër duar.

— O njeri i mirë! — i thirri Kola.

Ramoja u afrua. Përplasi disa herë gjuhën pas qiellzës me keqardhje. Ishte memec. Përndia i kishte marrë gojën, po mendjen e mirësinë s'ia kishte trazuar.

— Bjermë një grusht kripë, — iu lut Kola.  
— Më janë dërrmuar këmbët!

Ramoja tundi kokën dhe pas pak u kthye me një kapak kusie në duar mbushur plot, a thua se do të kripeshin këmbët e tërë fshatit.

Kola e mbylli frëngjinë dhe shkoi te dritarja e vogël. U kap pas hekurave dhe u ngrit në majë të gishtave aq, sa për t'i nxjerrë sytë mbi parvazin e dritares. Komandanti tok me nëpunësin e doganës po shkonin në zyrën e këtij të fundit për të bërë partinë e zakonshme të bellotës.

Pranë dritares u dëgjuan ca mjaullima. Ai buzëqeshi me djallëzi dhe ndolli maçokët, të cilët menjëherë kërcyen brenda.

\*

\*

\*

Të nesërmen u zgjua vonë, megjithëse kishte fjetur i kruspullosur, pa shtroja e mbulesë. Po s'prishte punë. Ai e bënte gjumin si manar edhe varur për këmbësh, boll ta kishte ndërgjegjen të qetë.

Aty afër u dëgjua e qeshura e komandantit, gurgulluese, sikur zbrazej një gjym me ujë. Ai hyri brenda i shoqëruar nga nënprefekti dhe sekretari.

— Ja, zoti nënprefekt, e zura me presh në duar! Harroi, derëziu, që qiraxhiu piqet me hanxhiun!

— Po çka ke ba, bre Kolë! — nisi ta qortonte nënprefekti, të cilit Kola ia kishte bukosur gojën me qefujt e majmë që ia çonte në shtëpi gati përnatë. — Po naltmadhnia ynë i ndritun, që allahu i shtoftë ymrin, e do dinamitin për mbrojtjen e atdheut nga rreziku bolshevik! Ah, jo, jo! Nuk e prisja prej teje kët gja!

— Jam i pafajshëm, zoti nënprefekt! Unë po vija nga Saranda, aty e kam blerë peshkun! S'e kuptoj pse më mbajtën brenda gjithë natën e natës!

— Saranda e sat ëme! — shau komandanti. — Ta tregoj unë ty Sarandën, pasi të kalbesh me 101 në kurriz!

— Zoti toger, flisni, flisni! Ju keni pushte-

tin, por edhe unë kam të drejtën! Unë do të ankothem, zoti toger, gjer lart në ministri do të ankothem!

— Mirë, mirë, të ankohesh, kush tha të mos ankohesh?! Shko njëherë në hapsanë, pastaj ankohe dhe te Aleksandri i Madh, po deshe!

— Po të ka kapë në flagrancë, bre Kolë, domethanë me presh në duar. Ka prova.

— Zotrote, nënprefekt, në qoftë se preshtë shkulen nga toka të qëruar e të pastruar, atëherë unë jam dakord. Unë peshqit i bleva në Sarandë. Ja, shihi!

Dhe një të rrëmbyer i bëri thesit dhe e zbrazi të gjithin në tokë.

Komandanti ngriu. Peshqit, jo vetëm që ishin të qëruar, por edhe qenë kripur. Kokrrat e trasha të kripës shkëlqenin djallëzisht, sikur talleshin me Xhevdet Sahanin.

— A, zotni Xhevdet, Kola paska të drejtë. Kjo është një provë ma se e mjaftueshme për fajësinë e tij.

— Mirë, mirë, — shfryu qejfprishur Xhevdeti, — po s'ke ku më shkon. Në mos nesër, pasnesër do më biesh në dorë!

Dhe doli duke e lënë derën hapur.

— Kolë, — i foli zë ulët nënprefekti, — jam shumë kurioz të provoj se ç'shije ka peshku i Sarandës...

— Ç'ke ti! — i shkeli syrin Kola. Nënprefekti doli duke lëpirë buzët.



Një maçok kokmadh po gromësinte në një  
cep të dhomës dhe, ashtu si nënprefekti, lëpinte  
buzët me gjuhën e vockël. Ndoshta i vinte plasje  
që ishte enjtur duke ngrënë të brendshmet e  
peshqve e s'mund të provonte dhe ca të kripur.

## HAKU

Ndodhia e mëposhtme ka bërë vaki disa dhjetëvjeçarë më parë dhe ndoshta protagonistët e saj nuk lëshojnë më hije mbi këtë tokë. Por, meqë jam i bindur se do të ketë lexues që në të do të gjejnë diçka nga vetvetja, po e ritregoj, natyrisht, me ndonjë zbukurim të vogël, që ma lejon e drejta e autorit...

\*

\*

\*

Shtëpia e Mitro Kimerës ishte krejt e mënjanuar nga fshati. Për të mbërritur aty, duhej të bëje nja dy orë të mira rrugë, me shpirt ndër dhëmbë, nëpër të përpjetat. Ajo ngrihej si karkoll në anë të monopazit që lidhte fshatrat e Bregut me ato prapa vargmalit të Vetëtimës. Vizitorë i hynin rrallë në shtëpi, po, kur i hynin, Mitroja i vinte flakën. Ishte i etur për

njerëz, gjithë kohën rrinte i shushatur e veç grindej me të shoqen. Djemtë ia kishin dredhur; qysh para se të martoheshin, ia patën thënë troç babës: «Mirë ne, na rrite si njerëz të egër bokërrimave, po fëmijët tanë duhet t'i rrahë era e jugës e t'i kripë uji i detit!» Dhe, meqë nipi duhet më tepër nga evlati, se është mish i mishit tënd, Mitroja kishte ngritur duart.

Atë natë kishte kthyer nga rruga Sharaf Derrodëmën, nga Lumasi. Sharafin e pati zënë muzgu nën shtëpinë e Mitros dhe ky kishte bërë adetin. Kishte tetë ditë pa parë njeri me sy. Tetë ditë që duhani i bëhej farmak e rakia i zinte fytyrën. Nga hareja i dha urdhër së shoqes t'i përdridhte qafën pikaloshit, gjelit kanakar, që çdo mëngjes e zgjonte Mitron nga gjumi.

U hëngër e u pi pa hesap. Rrokeshin miqtë për qafe e ngrinin pa pushim mirësira për njëri-tjetrin. E kur hëna nisi të gremisej në shtrat të detit, vendosën dhe ata të binin në shtroja, secili në odën e vet.

Mitros i doli gjumi vonë. Pa u ngritur, trokiti te xhami i dritares me bastun. E shoqja, që po lante pjatat në avlli, hyri duke fshirë duart me përparëse.

— Plaç, të preftë! — iu hakërrua Mitroja.  
— Do më zgjosh mikun!

— Ehu, — e përqeshi ajo, — miku tani do të ketë mbërritur në shtëpi të vet. Potkonjtë e mushkës së tij më zgjuan nga gjumi.

— Mitros i thirri xhebraili në vesh, ndaj brofi

rëmbimthi e vetëm me benevrekë iu drejtua ahurit të bagëtisë.

Pas një minute doli andej duke sharë e duke nëmur. I lutej zotit të merrte hak.

Cjapi Laran, i vetmi shok, krenaria dhe gëzimi i Mitro Kimerës, kishte bërë krahë.

\*  
\*      \*

S'ishte mbushur muaji, kur Sharaf Derrodëmaj kaloi prapë andej. Pinë nga një kafe e një cigare duhan më këmbë, se miku s'kishte kohë dhe, kur qenë gati të përshëndeteshin, Mitroja ia tha:

— Ma punuan piluriotët, Sharaf miku! Ma vodhën Laranin!

— Ç'thua, more! — u pataksh Sharafi. — Ç'qe kjo gjëmë që të gjeti, o i zi?!

— Ja, kështu. Po nuk do rri pa ua larë, jo!

— Jë i sigurt që ta vodhën piluriotët?

— Oj, i sigurt! Atë natë që qemë bashkë. Dhinë zbritën nga pllaja e Larani mungonte. Po nuk ta thashë, që të mos na prishej kënaqësia e muhabetit.

— Po si s'ma the, o Mitro vëllai?! Të kishim shkuar që atë natë e t'u qethnim bagëtitë!

— Pse, do vije, thua?

— Ç'është ajo fjalë?! Për mikun unë lë kokën!

— Vjen të shkojmë sonte?

— Në vend!

— Po mirë, hajde të pimë një gotë më parë, që të mbledhim takatin e pastaj nisemi!

Gotë pas gote, Sharafi thirr e rrih gjoksin e Mitroja derdh rakinë me marifet, u gdhi fare e doli dielli.

Atëherë të dy miqtë, zënë për krahu, u varën teposhtë. Kur mbërritën buzë detit, Sharafi u përmend disi:

— Mitro vëllai, po Piluri sikur është atje lart!

— Ee, po thashë të futemi njëherë në ujë, që të kthjellohemi!

— Prishur mos qoftë! — thirri Sharafi dhe nisi të zhvishej, nën shembullin e Mitros.

Mirëpo, sapo futi këmbët në ujë, u zmbraps i trembur:

— Mitro vëllai, po unë s'di not!

— S'ka gjë, të mbaj unë. Ja, të marrim një shullë diell tek ai shkëmbi aty.

Dhe nisi të notonte i sforcuar, sepse Sharafi e shtrëngonte fort e gati i merrte frymën. Shkëmbi ngrihej ndonja 60 metra larg nga bregu. U ngjitën me mundim dhe, pasi u rehatuan, Mitroja e pyeti:

— Hë, si je tani?

— Esëll fare!

— Vërtet?

— Për kokën tënde!

Atëherë Mitroja, ndonëse 50 e kusur vjeç,

u krodh me kokë si djalë i ri, doli nja dhjetë metra më tej e nisi të notonte drejt bregut.

— Mitroooo! — thirri i tmerruar Sharafi.

— Ç'ke?

— Mos më lër këtu!

— Aty të rrish!

— Siiii?! Obobo, unë i shkreti! Ububu, evlatët e mi të mjerë! Mos më lër, Mitro! Kush do më marrë mua që këtej?

— Larani! — iu përgjigj qetë-qetë Mitroja, që qe kthyer në shpinë dhe me sytë mbyllur po i gëzohej ngrohtësisë së diellit.

Sharafi ishte aq i mençur, sa ta nuhaste që Mitroja s'tallej. I qe krenuar vetes se ia kishte hedhur paq Mitro Kimerës, po dardha e paskësh bishtin prapa dhe, po të mos i binte rruga ndokujt nga ky plazh i shkretuar e i frikshëm si xhehnemi, ai do t'i linte shëndënë (kësaj bote, pa i provuar tërë kënaqësitë që mund të sajonte mendja e tij e shkathët dhe pjellore.

— Mitroooo! Më preve në bësë!... Të preftë mortja! — nëmi zëulët.

— Ku është Larani?

— Në shtëpi, more, në shtëpi!

— Ç'nishan u dërgon atyre të shtëpisë që të besojnë?

— Pse?

— Ç'nishan?

— Kutinë e duhanit.

Mitroja doli, u vesh shpejt e shpejt dhe nxo-

ri kutinë e duhanit nga xhepi i qillotave të leshta të Sharafit.

— Mitrooooo!... — vazhdonte të thërriste i dëshpëruar Sharaf Derrodëmaj. Zëri i vinte i mekur në veshët e Mitro Kimerës, i cili kishte marrë rrugën për në Lumas...

## NEVERIA

Pas 13 vjetësh, 3 muajsh e 13 ditësh, majori Lajosh G. zbriti më në fund në qytet. Gjithë këto vite i kishte kaluar në kazermat e Malit Gri, pa dalë kurrë tej mureve rrethuese, përjashto rastet kur zhvillohej taktika e këmbësorisë me ushtarët.

Ai kishte ardhur aty si një toger i thjeshtë i Perandorisë, i porsadiplomuar dhe bashkë me vifet e tij shkonin përpjetë edhe gradat. Pas pesë vjetësh u bë kapiten dhe vetëm dy muaj para se të zbriste në qytet u gradua major.

Vitet e gjata të jetës ushtarake ia kishin zbehur dhe gati zhdukur atij imazhin e qytetit. Për Lajosh G.-në jeta ishte ajo jeshilja e zbërdhlyt e uniformave të shajakta, tingulli i borisë, era e djersës dhe e vajit të armëve dhe, natyrisht, netët e gdhira në shërbim, kur ai nuk prehej asnjë çast dhe ushtarëve u pillte belaja e zezë me të. Duke marrë parasysh këto, kupto-



hej tamam se përse Lajosh G.-së iu deshën disa minuta që ta normalizonte hapin e tij të shtrirë e të fortë, domethënë, në njëfarë mënyre, ta civilizonte, ta shkrinte me atë ecjen e ngadaltë gjer në idiotësi të qytetarëve. Të këtyre qytetarëve matufë, që qenë veshur pa pikë shijeje, tërë lajle-lule, si ata fëmijët që porsa dalin nga shpërgenjta e nisin të hedhin hapat e parë në këtë botë të pjerdhur prej moralit civil.

Në qendër të qytetit sapo qenë instaluar dritat elektrike. Turmat kureshtare të njerëzve të ngeshëm shkonin e vinin ngadalë, si ujërat e ndenjura të një moçali, që era i trazon me mundim. Ai çapitej krejt indiferent, me një keqardhje cinike për ato qenie të mjera që mrekuulloheshin nga magjia fluoreshente. Eh, majori Lajosh G. e kishte konsumuar prej kohësh emocionin e elektrikut, qysh para tre vjetësh. «Gjithë shpikjet e njerëzimit ushtria perandorake i provon e para, me qëllim që, kur të duhet, t'i shkatërrojë ato me një të goditur!» mendoi ai jo pa triumf.

Duke u endur rrugëve pa asnjë shkak e qëllim, dhe aq më tepër pa rrezikun e takimit me dikë nga kjo turmë mediokre, që i konsumonte energjitë në mënyrën më vanitoze, (për fat të mirë, pas vdekjes së prindërve ai s'ishte lidhur me asnjë nga miqtë e tij të hershëm, kështu që këta ia kishin shpërblyer heshtjen me harrim), ai u fut në një rrugicë të errët, ku

ndriçonin zbehtë, si sy të shuar, vetëm dritat e shtëpive. Gjithçka i dukej e shëmtuar dhe e parëndësishme. Këta njerëz, që s'e vrasin mendjen për asgjë, këto bretkosa moçali, do të qëmirë t'i kishte aty, në kazermat e veta; t'i ngjiste duke rendur, me të tëra pajimet, gjer në majën e Malit Gri e aty ta merrnin vesh ata se çështë ushtria dhe ushtari; aty t'u dilte nga hundët qumështi i nënës e të mos reshtnin së puthuri këmbët e Lajosh G.-së për mëshirë.

Pa e ndier, kishte nisur t'u ngjitej shkallëve të ngushta, që vinin era shurrë e ndenjtur, të një ndërtese me arkitekturë të çoroditur. Ah, po! E kishte tërhequr emblema ushtarake, që qëndronte në krye të portës.

Ushtarë e oficerë të tjerë ngjiteshin e zbritnin. Kush me xhaketë në dorë, kush duke mbërthyer a zberthyer pantallonat, duke folur me atë fjalorin neveritës, që vetëm në gojën e një ushtaraku të Perandorisë mund të kishte një tingëllim çuditërisht të bukur.

Hyri në të parën derë që gjeti hapur. Gjysmerrësirë, gati si të shkallët; vetëm një dritëz jeshile ndriçonte dinakërisht mbi një krevat hekuri, që ende vazhdonte të kënkëllinte përvajshëm.

E kuptoi se gjendej në bordelin ushtarak të qytetit, por ishte vonë. Një vajzë 17-18-vjeçare, krejt lakuriq, qëndronte me shpatullat pas derës, duke buzëqeshur në mënyrë enigmatike. Në medalionin që kishte varur në qafë

shkëlqenin shifrat 8723. «I 8723-ti ushtar i Divizionit Kurvëror të Ushtrisë Perandorake!» rrudhi buzët me përçmim Lajosh G.-ja. Vajza, pa u afruar, ndeu dorën përpara dhe, kur pa se majori ngriti supet, fërkoj gishtin e madh me treguesin.

Majori Lajosh G., si automat, i dha asaj gjithë paratë që i zuri dora në xhep. Vajza hapi sytë e habitur dhe pastaj u shtri në krevat me një pamje që edhe vetë Krishtin do ta shtynte të mëkatonte.

Mekanikisht majori u zhvesh dhe u shtri pranë saj. Atëherë 8723-shi nisi të kryente punën e vet, me mospërfilljen dhe përpikërinë e zanatçit të mbaruar. Kurse Lajosh G.-ja heshte, i ftohtë dhe i palëvizur, si ndonjë gur i harruar kushedi prej kujt.

8723-shi vazhdoi dhe ca, pastaj u mërzi. Susta e ndryshkur e krevatit kërciti si raketake për pak çaste dhe pastaj u bë qetësi.

«Sa poshtë paskam rënë!» mendoi majori. Dikur, djalë i ri, e kishte rrëqethur edhe atë dëshirimi i trupit femëror. Dikur, tok me dy bashkënxënës të tjerë, e kapërcenin shpesh murin e lartë të Akademisë Ushtarake dhe shkonin dhe e kalonin natën në shoqëri me tri lavire polake te Rruga e Postës. Tani ai po habitej me veten se si, kaq e kaq vjet, as që i kishte shkuar ndër mend një gjë e tillë. Dhe habinë më të madhe ia jepte fakti që përse nuk po ndiente asnjë lloj kënaqësie nga gicilimet e pros-

titutës, por, përkundrazi, ndiente një krupë, që po ia sillte zorrët te goja.

Lajosh G.-ja e shtyu fort e me mllef dhe prostituta ra nga krevati. Majori ia nguli sytë dritës së gjelbër, që atij i dukej e shpëlarë dhe neveritëse, si kokë ushtari e qethur taze.

Prostituta, si prostitutë? U hakmor në çast. Rrëmbeu rrobat e majorit dhe i flaku nga dritarja në errësirën e natës, aty ku angullinte ndonjë qen, apo nxirrte gazrat ndonjë ushtar injorant.

I mbështjellë me çarçafin e bardhë të krevatit të bordelit, majori Lajosh G. ngjante si lugat. Duke kërkuar më kot rrobat e tij nëpër terrin që vinte era ndyrësirë, ai po mendonte se Perandoria do t'i kishte punët pisk për sa kohë do të vazhdonin civilët të livadhisnin. Ata duhej të mobilizoheshin të gjithë, të mos ngelte këmbë pa u mbathur me këpucët e rënda të ushtrisë. Dhe t'i merrte vetë Lajosh G.-ja në komandë, t'u bënte një taktikë këmbësorie nëpër Malin Gri e t'ua nxirrte nga hundët qumështin e nënës...

## DËNIMI

Që andej lart deti dukej i zi e i palëvizshëm, si një vaskë e paanë bitumi. Flladi i lehtë, që nuk reshtte kurrë në atë majë mali, e fashiste nxehtësinë përvëluese që rrezatonin pllakat e mëdha të gurëve e shkëmbinjve. Cinxërit të shurdhonin me këngën e tyre monotone dhe herë-herë ndonjë zhapik ia bënte «fësht» nëpër shkurret.

Ata e kishin nisur luftën që herët dhe po e vazhdonin me një vrull e entuziazëm marrok. Çjerrë e gjakosur në krahët, me gjunjët të bërë copë nga strallet, shkonin e vinin faqes së mallit, pa pyetur për rreziqet. Të pangrënë e të këputur, luftonin për jetë a vdekje, të bindur se fitorja për secilën palë nuk qe larg. Po përfundimi i betejës largohet, ashtu si plaku dembeliell që po çapitej nëpër qiell, rrugës drejt përrëndimit.

Kalamajtë e Vanovës qenë shpërndarë në formacion luftimi. U kishte rënë shorti që të

mbronin gjineshtrën e vetmuar, pushtimi i së cilës shënonte përfundimin e luftës, dhe ata po e kryenin këtë detyrë me vetëmohim, si burra të rritur.

Kalamajtë e Dushkasit rropateshin më kot, tërë ditën e ditës, që të preknin gjineshtrën. Vanovasit u vërvitnin rrokopujë gurësh e plisash dhe nuk i linin armiqtë as të ngrinin kokën.

Më i madhi i dushkasve, njëkohësisht edhe komandant i ushtrisë së tyre, një djalë llapush e buzëtrashë, 12-13 vjeç, i qe afruar tinëz vendit ku ruante, (s'kishte hyrë ende në luftë), Nono Caceja, një çamarrok shtatëvjeçar. Pak çaste më vonë llapushi tundi në erë si flamur të bardhë këmishën e tij dhe i pëshpëriti Nonosë: «Hajde bëjmë një marrëveshje!» Nonoja rrëmbëu gurin, po llapushi ia preu hovin, duke i folur shpejt e shpejt: «Dale, a i vrrarë! Unë jam dorëzuar, nuk e sheh?» dhe përsëri valëviti këmishën.

— Mos u qas më pranë! Fol që aty ku je!  
— e urdhëroi Nonoja.

— E sheh këtë? Ta kam falur! — i buzëqeshi llapushi dhe i tregoi një shpatë të vërtetë, që ndriste nga lëmimi. Nonosë i ilku zëri. Ajo, siç thoshin në fshat, qe një shpatë e kohës së Ali Pashës dhe s'dihej se qysh kishte rënë në duart e llapushit. Vetë ai u qe mburruar kalamajve se gjyshi i babait të tij me atë shpatë kishte bërë kërdinë kundër turqve.

— Hë, pra! Na, merre! — ia hodhi shpatën

para këmbëve llapushi. Tringëllima e tëhut nëpër gurët e përmendi Nononë. Ai u ul dhe e mori shpatën nëpër duar, duke e përkëdhelur ngadalë e me kujdes, a thua se druhej mos i lëndonte trupin e metaltë. Në ato çaste ai s'qe më një kalama i klasës së parë fillore, por një burrë i rritur, një luftëtar trim, Skënderbe i vërtetë. I mbylli paksa sytë dhe u mundua të përfytyronte habinë dhe lutjet e shokëve për ta prekur pak me dorë.

Duke menduar këto, ai buzëqeshi, mirëpo, sa ngriti sytë, gazi i ngriu. Llapushi po ngjitej si lepuri përpjetë dhe pas pak këputi një degë gjineshtre e nisi ta tundte fort në ajër — flamur fitoreje.

\*

\*

\*

Po binte muzgu kur vanovasit u mblodhën të-tërë tok për t'i dhënë dënimin Nonosë. Nonoja ishte shkaktari i disfatës, ai ishte dezertor. Dhe dihet, për tradhtarin e dezertorin s'mund të ketë asnjë lloj mëshire. Ai i shkreti i pranoi të gjitha dhe tha me sinqeritet se meritonte dënimin më të rëndë.

Trupi gjykues u tërhoq mënjanë dhe, pa kaluar as një minutë, u kthye e shpalli vendimin:

1. Shpata do t'i dorëzohet komandantit të ushtrisë së Vanovës!

**2. Tradhtari Nono Cacija dënohet me vdekje! Meqë nuk kemi armë për të kryer pushkatimin, i dënuari do të hidhet nga gremina!**

Nonoja i vështroi një nga një shokët. Për herë të fundit. Ata qëndronin gojëkyçur, me sy të menduar, që rrezatonin një ftohtësi akullnaje.

Ai eci ngadalë drejt greminës, pastaj nuk e zgjati, mori vrull dhe u hodh.

\*  
\*       \*  
\*

Sikur bluza e leshtë e Nono Caces, (ai që shëndetlig dhe i vishnin bluzë të dhirtë në mish), të mos kapej pas një kërcuri, nja 20 metra nën buzën e greminës, ndërmarrja e ndërtimit në qytetin e vogël bregdetar do të kishte sot një murrator më pak. Atë natë Nonoja e gdhui duke u mbajtur në fije të perit dhe vetëm të nesërmen afër drekës, dy ushtarë të xhenios mundën të zbritnin gjer aty, ta lidhnin me litar dhe pastaj të tjerët e tërhoqën dhe e ngritën lart. Tanimë ai është martuar, ka dhe dy fëmijë, djalë e vajzë. Jeton i lumtur dhe gjendet ngaherë në humor të mirë. Vetëm se, sa herë bëhet fjalë për ndonjë tradhti, qoftë edhe të vogël në jetë, ndien një shtrëngim në zemër dhe, ndryshe nga natyra e tij gazmore, gjithë atë ditë rri si mbi gjemba, me një hije trishtimi në fytyrë.



## QARTËSIA E JETËS

Mes katrahurës së avujve, që e bënin peizazhin pasdrekor të ngjante me fytyrën e një gruaje që s'e kish fshirë tualetin e pardjeshëm, vajza kaloi si një zog në fluturim. Ai i rراسi edhe më sytë pas DVK-së dhe u mundua ta ndiqte, por ajo tashmë kishte hyrë në ullishtën e dendur. Herë-herë bluza e saj e kuqe fanitej midis boshllëqeve të pemëve, si një diell mbrëmësor përmidis reve. Në të majtë të ullishtës zbardhte përroi. Tërë ajo bardhësi e përgjumur, megjithatë, ia lëbyri sytë deri në dhimbje dhe ai i fërkoj fort me gishtin e madh dhe treguesin e dorës së djathtë. U përkul përsëri mbi dylbi. Ah, i iku!...

Por jo. Ajo po hynte në portën e shtëpisë. Një portë e rëndomtë dykanatëshe, prej llamarine të fortë e shufrash hekuri, lyer me bojë kundër ndryshkut. Një hap, dy, tre, dhe ajo, si e bukura e përrallës, u zhduk nëpër blerimin e virgjër të pjergullës.

U dëgjua çanga, që lajmëronte mbarimin e pushimit, dhe ushtari u var me vrap për në

qendër të repartit, ndërtesat e të cilit qëndronin si qëndisma në sfondin e blertë pranveror.

\*  
\*       \*  
\*

Të nesërmen, sapo u bë zgjimi, nuk e përballoi dot tundimin dhe u vodh e u ngjit në pozicion të zjarrit. E mënjanoi paksa DVK-në nga vendi i zakonshëm dhe i drejtoi gypat te shtëpia e Zogut të Kuq. Piu tri cigare njëërën pas tjetrës, gjersa ajo doli. Përsëri veshur me bluzën e kuqe e fundin e zi. Ai e anoi kokën djathtas, por sytë e tij qenë të pafuqishëm për të tejshkuar tisin mëngjesor. Zallishta tani nuk ngjante as e përgjumur e as e fjetur, por krejtësisht e vdekur, pa asnjë shenjë jete përmbi të. Qelqet ia afruan përsëri vajzën, që po ecte disi e kontraktuar, për shkak të zajeve të mëdha, të cilat me siguri kërkitnin shumë pak nën peshën e trupit të saj.

Qeshi me vete. Ai, që kurdoherë e kishte parë jetën dhe gjithçka përreth vetëm me sytë e tij, (vërtet pak të prekur nga një simptomë astigmatizmi), pikërisht tani, në moshën 24 vjeç, kënaqej duke e soditur atë nga larg, me një instrument optik, të ngritur mbi tri këmbë, që quhej «Dylbia e Vrojtimit e Komandantit», shkurt, DVK, dhe që e jepte tejet të qartë çdo imtësi të peizazhit.

Ishte kjo qartësi absolute, si e ardhur nga

një planet i panjohur, që herë-herë ia akullonte ndjesitë ushtarit.

Ajo po ecte tani në rrugën e asfaltuar, duke lënë pas një ankth të ëmbël, që mbërrinte deri tek ai në trajtën e rrezeve fluide, por therëse gjer në palcë.

\*

\*

\*

Kishin kaluar vite të tëra, ndoshta shekuj, që nga ajo pasdite pranverore, e cila kishte hyrë në jetën e ushtarit ngadalë, pa u ndier, ashtu si rrezet e diellit në trupin e njeriut.

Në fillim e kishte marrë thjesht si argëtim përgjimin e përditshëm të Zogut të Kuq, (që ende nuk i dinte emrin), po më vonë i qe kthyer në domosdoshmëri, për të mos<sup>o</sup> thënë në një mani këmbëngulëse. Gjersa, një të diel korriku, e kishte kuptuar se e dashuronte. Kishte qenë në plazh ajo. Mes asaj mizërie kaotike trupash, ngjyrash, rrezesh e stërkalash të arta, ai do ta njihnte vajzën, edhe sikur ajo të qe mbuluar me ferexhe. Nuk ishin më tepër se 300 metra larg, prandaj trupi i saj shquhej kaq mirë. Mospërfillëse, si shkëmbinjtë nënujorë, ajo i kishte kthyer shpinën detit dhe po lexonte një libër. Qelqet, si duar magjike, e afronin gjoksin e saj, të bëshëm e tërheqës gjer në tundim, sa të krijohej patjetër ndjesia e prekjes së tij. Ushtari Edi Kroj ndjeu

në trup një zjarr të çuditshëm. Dhe, sapo zabullima i kaloi, si një ndryshim i befasishëm i motit, trupin ia rrëqethi një mendim i mirë, i bukur, torturues: E dashuronte!

\* \* \*

\*

Por ishte pikërisht kjo gjë që e tronditi.

Dashuronte një gjë të largët. Dhe, ndonëse aparati e afronte gati 30 herë, iu duk sikur edhe ia largonte po aq. «Një dashuri e akullt!» mendoi Edi Kroj dhe hodhi sytë në thellësinë e qiellit, sikur të kërkonte atje një imazh, një imazh të vërtetë, pa ndërmjetësinë e ftohtë të syve të xhamtë të aparatit.

**1986**

## TAKOHEMI PASDITE

Kur doli në shëtitore, pati përshtypjen se po binte shi. I mbylli sytë dhe i shqoi vërtetë rigat e buta dhe retë që po aviteshin nga deti. Për një çast e rراسi kokën mes supeve, se u tremb nga një vetëtimë e befte dhe pastaj vazhdoi të ecte me hap normal e me një buzëqeshje faji në cep të buzës. Ora e madhe te Komiteti Ekzekutiv i Rrethit shënonte 4,10'. Deri më katër e gjysmë kishte kohë, pra s'bënte keq të mërzentë ca prapa pallatit të kulturës, ku patën rinisur gërmime arkeologjike.

Më katër e çerek ai doli me vrap nga shtëpia dykatëshe pranë stadiumit. Ishte fëmija i fundit, i pleqërisë, i një familjeje të madhe, pjesëtarët e së cilës qenë rritur, qenë martuar e shkëputur nga trangu, duke lënë aty vetëm prindërit, që plakeshin dita-ditës, dhe këtë pinnjollin kanakar, student në vitin e tretë filozofi, që shkojevinte në fakultet përditë, ikte me trenin e gjashtë pa njëzetës dhe kthehej me atë të orës 5,30... Deri në qendër i donte të paktën

dhjetë minuta; ai nuk duhej të vonohej asnjë sekondë, sepse ky ishte takimi i tyre i parë dhe në një rast të tillë, korrektesa (ose moskorrektesa) parathotë shumë gjëra.

Më 4,25 ajo u fsheh pas një palme dhe priti që ai të dilte te sheshi para shatërvanit të vjetër. Gjithsesi ndihej e emocionuar; një si këputje e gjunjëve i shkaktonte një trazim në stomak e ia vështirësonte frymëmarrjen. Prindërit nuk i kishte konservatorë dhe qe e sigurt se, duke dalë në takim me një djalë, as i fyente ata e as bënte ndonjë sakrilegj. Po ç'ti bënte opinionit! Ky qytet i madh e pak i çuditshëm, për faktin se qysh më tetë të darkës rrugët boshatiseshin, kishte ca gojë që aman o zot! Prandaj ajo po rrinte tani e fshehur pas pemës, si në një lojë kukamfshehthi. Me kë luante, vallë, me djalin, apo me opinionin?

Kur ai mbërriti te vendi, donte edhe 2 minuta që akrepi i madh i orës të shkonte te gjash-ta. Mori frymë i lehtësuar dhe i bishtënoi turmës së njerëzve që, si një mekanizëm stërmadh i kurdisur nga një dorë e padukshme, i ngjitej e i zbriste shëtitorës, që vazhdonte deri në breg të detit. U mbështet pas një peme, prej nga e vëzhgonte fare mirë vendin ku e kishin lënë të takoheshin: te sheshi në një cep të shatërvanit të vjetër, ku ata do të piqeshin si krejt rastërisht, si krejt të panjohur e me ca pëshpërime gati të pakonceptueshme do të merreshin vesh në mes tyre.

Ata shkojnë e vijnë çdo ditë në Tiranë, me të njëjtin tren. (Shumë rrallë prishet ky rregull). Ka dy vjet kjo punë. Djali, pra, studion për filozofi, kurse vajza është në vit të dytë, dega kimi industriale. Ato ultrandjenjat e padukshme e ndoshta edhe të paimagjinueshme i hodhën drejt njëri-tjetrit, në fillim si me drojë, por, duke kaluar koha, fare natyrshëm. Dhe sot, ndërsa po ktheheshin me trenin e 12-s, në të njëjtin kompartment, djali nuk i tha atë formulën shabllone «Të dua», apo ato fjalë skandalërisht romantike «Unë... të dashuroj». Jo, ai iu shpreh disi ndryshe, më saktë, krejt ndryshe:

— A takohemi pasdite?

— Takohemi, — tha jo, — po ku dhe kur? Djali u mendua pak, pastaj i qeshi fytyra:

— Te shatërvani, më katër e gjysmë.

— Po aty... na shohin!

— Asnjëri s'ka për të na parë. Njerëzit kureshtarë i mbajnë sytë nëpër skuta.

Ora po shkonte 5 pa 20. Ajo u shqetësua. Ç'ti kishte ndodhur, vallë? S'kishte mundësi as të tallej. Aq më pak që ky ishte takimi i tyre i parë.

Pranë shatërvanit shkojevinin shumë njerëz, të moshave të ndryshme. Muzgu po nderej ngadalë, megjithatë, ngaqë ishte më errët te vendi ku qe fshehur, ajo e shihte si në pëllëmbë të dorës tërë rrugën ku do të duhej të ishte ai.

Akrepat e orës tregonin 5 pa 20 fiks. Djalin,

tok me padurimin, e kaploi edhe një ndjenjë meraku. «Eh, psherëtiu, si janë këta prindërit! Me siguri s'e kanë lënë të dalë!» Ç'është e vërteta, ai e ndiente tutelën e prindërve. Prandaj dhe qe fshehur këtu: që të mos ekspozohet në sy të njerëzve, fjalët e të cilëve, dikur, do të binin patjetër në vesh të babës së tij. Dhe atëherë do të nisinin ato çastet bezdisëse, të cilat ai, me krenarinë e djaloshit 23-vjeçar, do t'i përtypte si patate të paziera. Nga halli, jo nga malli.

Pesë fiks. Kjo s'durohej! Të ishte kaq jokorekt?! «Bërr, ç'fjalë! Si bluarje kockash! Po mirë, si i besova unë budallaqja? Ku e njoh unë atë! A mjafton vetëm një udhëtim me tren? Ku ta di unë se ç'bën ai pjesën tjetër të ditës, qoftë këtu, qoftë në Tiranë. Me siguri e ka pleksur muhabetin me ndonjë tiranase dhe do të hyjë kollovar. Ih, më marrtë pleshtat mua! Po s'e ka fajin ai, jo! E kam unë, që i besoj si të jem kalama! Megjithatë ku i dihet? Ndoshta e ka një hall vërtet. Do të pres deri në pesë e gjysmë.»

Ja, ora vajti pesë. Djali nisi t'i përplaste këmbët përtokë, si mëz xanxar. «S'ka pse ta pengojnë prindërit. Ata, po të qenë të tillë, s'do ta linin fare çupkën e tyre ta vazhdonte shkollën në Tiranë. Po thuaj do t'i kenë gjetur ndonjë burrec 35-vjeçar, ndonjë ekonomist, beqar të staxhionuar! I bien lapsit, jo shaka! Profesorë të mbaruar, bashkë me të bijën... Por edhe unë, qenkam një rrotë që s'gjendet i dytë. E vras



mendjen për të. E virgjër dhe e ndershme si shën Mëria me qenë, ajo duhej të dilte sonte këtu, pa një pa dy. E shoh se nuk ia vleka. Ajo s'u tregua korrekte qysh në takimin e parë, vaj hallit në ditët e mëpastajme...».

Ora pesë e gjysmë. Ajo vështroi një grimë për herë të fundit nga shatërvani dhe pastaj ia dha vrapit si e marrë, duke shpresuar se kështu do ta përmbante vërshimin e lotëve.

Ora pesë e gjysmë. Ai psherëtiu me një «eh» të thellë, rراسi duart në xhepat e xhakoventos dhe me hapa të ngadaltë nisi të ecte në krah të kundërt. Ndjeu një goditje në ijë dhe u përmend. Dëgjoi një «na fal», pa siluetat e një djali e një vajze, të ngjitur njëri me tjetrin, që ecën dhe pak, pastaj u shkrinë me turmën e njerëzve që, si një mekanizëm i kurdisur nga një dorë e padukshme, i ngjitej e i zbriste shëtitores, që vazhdonte deri në breg të detit...

Tavohemi  
mbasojte.

Hy

1990

## KURBANI I MIQËSISË

Në orën tetë të darkës përgjegjësja e ndërresës na njoftoi se do të punonim 12 orë, pra deri më 2 pas mesit të natës. U mërzitëm të gjithë e bëmë sherr, po më në fund u bindëm se ajo s'kishte asnjë faj. Urdhri që dhënë nga drejtorja dhe, edhe ajo, edhe ne, qemë të detyruar ta zbatonim. Ato ditë fabrika punonte me dy ndërresa, sepse sezoni i frutave sa kishte filluar. Në fakt ajo s'ishte gjë tjetër veçse një punishte moderne me 20 punëtorë, por si në çdo qytet të vogël, ku përmasat reale të gjithçkaje jepen të zmadhuara, edhe këtë e quanin fabrikë të përpunimit e konservimit të frutave.

Pjesa më e madhe e punëtorëve qenë femra, shumica nuse të reja, qemë edhe katër çuna beqarë, më i riu unë. Ishte edhe Drita, një vajzë e lezetshme dhe e shkathët, që sapo kishte mbaruar maturën. Kishte në vetvete një sqimë të bukur, e cila na bënte të druajtur ne djemtë dhe silleshim disi artificialisht me të. Kurse ajo, plo-

tësisht e ndërgjegjshme, miklohej nga kjo gjë dhe luante pa të keq (besoj!) me ne.

Me Dritën i kishim shtëpitë në një mëhallë dhe unë u qetësova kur mendova se do ta bënim bashkë rrugën nëpër natë. Sepse nata, tok me misterin, mbart në vetvete edhe intimitetin. Si domos kur mes për mes saj ecin dy të rinj, midis tyre krijohet një marrëveshje e fshehtë, e mirë.

Por s'qe e thënë që kjo marrëveshje të krijohej edhe mes meje e Dritës. Sepse, kur po laheshim e pas pak do të iknim, Shqipja, që e kishte burrin oficer, m'u afua dhe m'u lut ta përcillja për në shtëpi, pasi Astriti, i shoqi, ishte me shërbim atë natë. Nga natyra jam tip që s'ia prish njeriu, aq më pak një gruaje të re, siç ishte Shqipja. Kështu që, ndonëse i mërzhitur sepse pallati i saj ishte në drejtim të kundërt me shtëpinë e Dritës, pranova duke tundur kokën.

Nata ishte e bukur. Qielli, i tejngopur me qumështin e yjeve, përcillte deri te ne një dritë të butë e të prekshme. Dritat e shtëpive anës rrugës qenë fikur gati të gjitha, dhe kjo sikur të impononte heshtje. Shqipja kishte një trup kaba të madh, por tepër elegant. Nuk ecnim shpejt, por, ngaqë rruga qe e paasfaltuar, unë dalloja se në çdo hap asaj i kërcenin gjinjtë e bëshëm. Ish-te një grua e zakonshme, me kulturën që mund të ketë një grua e tillë, por edhe me një etikë që binte në sy. E qeshur, e drejtë, dinjitoze dhe

pak si e veçantë nga disa gra të tjera atje në punë.

— Qenka bukur sonte, — foli Shqipja.

Unë tunda kryet:

— Sidomos kur je vetë i dytë.

Dhe, nga frika se mos më keqkuptonte, shtova:

— Kur mbaroj turnin, nuk iki rrugës drejt, por eci bregut të detit, Ulem diku e rri gjatë. Bisedoj me detin, dëgjoj zërin e tij dhe ia kuptoj të gjitha fjalët. Dhe ndoshta se është aq bukur më vjen keq që këtë bukuri ta shijoj vetëm unë, të mos ketë edhe të tjerë pranë meje që të bëjnë të njëjtën gjë....

Ajo qeshi zë ulët:

— Sa bukur di të flasësh ti!

Unë s'fola. Po përpiqesha të merrja me mend nëse edhe ajo mendonte të njëjtat gjëra si unë. Ç'do të bënte, vallë, sikur unë të ndaloja, ta zija për supesh e ta afroja drejt vetes? Më shumë kishte mundësi të mos reagonte fare. Dhe atëherë unë s'do të guxoja kurrë më t'i dilja para syve. M'u duk vetja i poshtër, por ia hodha fajin natës dehëse dhe sikur u qetësova. Në fund të fundit, njeriu nuk bën mëkat nëse e mendon çdo gjë mbarë e mbrapsht, qoftë të mirën, qoftë të ligën.

Shqipen e shoqërova deri në kat të tretë, ku kishte shtëpinë. Ajo ma shtrëngoi dorën pak më gjatë se normalisht. Ose kështu m'u duk mua.

— Gjumë të ëmbël, — tha, — dhe falemnderit!

Unë zbrita shpejt shkallët. Në cep të pallatit m'u duk se pashë një hije, po s'i dhashë rëndësi.

Të nesërmen më doli gjumi vonë. Kokën e ndieja të rëndë, sikur më kishin varur një gur të madh në qafë. E gjerba me bezdi kafen që më ishte bërë si lëng gështenjash dhe dola në rrugë. Mizëria e njerëzve poshtë në plazh zukaste mbytur dhe mua më iku qejfi për t'u larë në det.

Burrin e Shqipës e njihja vetëm si fytyrë. As isha përshëndetur ndonjëherë me të. Prandaj u çudita kur më foli dhe mendja më shkoi në çast për keq.

— Kam qejf të pimë një gotë bashkë, — tha, — dhe e di që s'do të ma prishësh!

E pse t'ia prishja?

Hymë në bufe dhe u ulëm në të parën tryezë që gjetëm bosh. Astriti porositi dy dopio konjak. «Mua ma bëj ponç», i thashë kamerierit. Poncin e kisha dorë me një për dhimbjen e kokës. Pas pak ne i cakërruam gotat dhe, si bëmë një ripërsëritje të formaliteteve të mëparshme, «vetë mirë, nga shtëpia mirë», etj., etj., ai foli duke më parë drejt në sy:

— Për babanë tënd, doktorin, kam shumë respekt. Kemi ardhur një herë me Shqipën në shtëpinë tuaj, se do të vizitohej, punë grash, dhe na pritën shumë mirë, sikur të njiheshim prej kohësh. Ti, besoj, e di, unë s'kam as një vit që

kam ardhur këtu, kështu që vendasit i njoh fare pak. Dhe aq më pak mund të kem miq mes tyre. Detyra ime është e tillë që ma kufizon shumë kohën e lirë. Edhe atë që kam, e konsumoj në shtëpi, me Shqipen. Çift i ri, — buzëqeshi. — Nuk kam pasur kohë që të njihem, më kupton? Mirëpo ndonjëherë njeriun e njeh edhe brenda një çasti të vetëm, jeta e vë atë përballë një prove të vështirë dhe mënyra se si e përballon ai, mund të flasë më tepër se 20 vjet njohje.

Unë po e dëgjoja pa ndonjëfarë interesi, për mirësjellje tundja kokën, ngrija nganjëherë gotën dhe thithja cigaren që s'po më shijonte edhe aq.

— Mund të të duket qesharake dëshira ime, — vazhdoi Astriti, duke lëmuar me gishta buzët e gotës, — ka rëndësi që unë të flas singërisht. Do të doja të bëheshim miq bashkë. Shtëpia ime të jetë dhe shtëpia jote. Unë jam i bindur se ti e vlen miqësinë time.

U bëra më i vëmendshëm. Po e kundroja përmes tymit dhe s'po u jepja dot dum fjalëve të tij. Ku donte të dilte? Në fund të fundit, unë as që e njihja fare atë, madje as gruan e tij. Një muaj punë bashkë me Shqipen s'mund të quhej kohë e mjaftueshme, aq më pak po të mendoje se me të unë isha sjellë njëllë si me shoqet e tjera të punës, (me përjashtim të një nate më parë), pa e vrarë mendjen për t'u afruar më tepër e për t'u miqësuar me të.

— Njeriu, — thashë, — më tepër se për çdo gjë ka nevojë për miq. Dhe kuptohet, unë s'jam i marrë që ta refuzoj ofertën për një miqësi. Në fund të fundit, gjithçka në jetë është reciproke. Por do të doja të mësoja diçka, në qoftë se mundesh, natyrisht. Nga dhe pse je i bindur se unë e meritoj miqësinë tënde?

— Po, — buzëqeshi ai, — u binda mbrëmë, më saktë, sot në të gdhirë. Mbrëmë, më dhjetë pa dhjetë, unë erdha në fabrikë që të merrja Shqipen e ta çoja në shtëpi. Por, kur më tha se do të punonit gjer më dy, ngela. Ç'të bëja? Nga reparti kisha zbritur pa lejë, isha vjedhur, kupon? Të zbritja prapë, ishte punë që s'bëhej. Megjithatë ia lashë Shqipes në dorë, ndaj, kur më tha se do t'i lutej ndonjërit prej jush ta shpëronte, nuk e dhashë veten. Mirëpo, sa u ngjita në repart, nisën të më gërryenin dyshimet. Nuk më mbante vendi. Më dukej se tërë ushtarët qenë ngritur nga gjumi e po talleshin me mua. Më në fund s'durova, thirra nënoficerin e rojës dhe i thashë se do të shkoja për kontroll në një pikë shërbimi që ishte një orë larg nga reparti. Kur zbrita, dyert e dritat e fabrikës qenë mbyllur, ora ishte dy e dhjetë. Qëndrova për pak në mëdyshje, pastaj sesi më shkuan sytë tej dhe ju pashë ju të dy tek largoheshit nëpër natë. Atëherë, e di që do të të vijë keq, — nxitoi të më sqaronte, — po koka e falur nuk pritet, ju erdha pas. Duke ecur fshehurazi pas jush, aq afër, saqë gati merrja vesh edhe fjalët, më vinte

ta shqyeja time shoqe. Më mirë të ikte vetëm në shtëpi, sesa e shoqëruar. Dhe po t'i ndodhte gjë, të mbrohej vetë. Sepse bota kanë sy edhe natën, sidomos natën, kur një femër, e sidomos një grua e martuar, ecën bashkë me një djalë, me të cilin s'e lidh asgjë, kushdo mund të flasë ç'të dojë të nesërmen...

Mua po më hipte gjaku në kokë. Ponçi, me të cilin më kishte gostitur ai, po më ngjitej në grykë dhe u frika se mos të vjellat shpërthenin mbi tryezë. E, ndërsa ai fliste e fliste, trurin po ma rrihnin si vare të njëjtat fjalë: Si mund ta bëj mik këtë njeri?... Si mund ta bëj mik këtë njeri?... Si mund....



## PAGJUMËSIA E SARËS

Qyteti u çua nga gjumi veshur me këmishë-natën e dëborës. Dhe kjo ishte dhurata më e bukur që Viti i Ri i bëri qytetit të vogël bregdetar, banorët e të cilit e adhuronin borën, ngaqë nuk e kishin asnjëherë. (Për të qenë i saktë, duhet të them se qyteti e vishte rrobën e bardhë shumë rrallë, një herë në 10-15 vjet). Mes gjelbërimit të pemëve e detit të kaltër, të plumbtë, jeshil, të zi, (sipas stinëve), ngriheshin shtëpitë e lyera me gëlqere-imitacione të çiltra të masive prej dëbore. Për vite me radhë në qytet ishte krijuar kulti i dëborës, ashtu siç kishte qenë dikur, gjysmë shekulli më parë, kulti i bukës së grunjtë. (Qyteti atë pak tokë buke e shfrytëzonte për ta mbjellë me ullinj, nga shitja e të cilëve blinte grurin, sepse, edhe po t'i bashkonin në një të tërë të gjitha ngastrat e tokës, zor se bëhej drithë më shumë se për dy muaj).

Dëbora i gëzoi të gjithë, sidomos fëmijët. Dhe më i gëzuari ndër ta ishte Juli Vojniku, një vogëlush 6-vjeçar, i cili atë vit kishte hyrë në shkollë dhe për herë të parë kishte mësuar se na qenkësh një miell i bardhë si niseshteja dhe i ftohtë si akullorja, që bie në dimër dhe mbulon baba malin që të mos ftohet. Juli, pra, sa doli jashtë, ngeli për një çast i habitur dhe pastaj i thirri së ëmës:

— O ma, kanë rënë qarçafët nga teli!

Sara, që po i rrihte vezën djalit, buzëqeshi dhe thirri nga brenda:

— Nuk janë qarçafë, mor bir, është bora!

Bora?!... Juli i zbriti me vrap ato pesë shkallë, këmbët iu zhytën si në shkumën e sapunit dhe ai nisi të këndonte me lalala nga kënaqësia. Pastaj mori një grusht borë dhe ngjiti gjuhën në të. Brr! sa e ftohtë! Mirëpo vogëlushit iu pre gëzimi në mes. «Maja», që sipër verandës, i bërtiti:

— Juli, shpejt brenda, se do të ftohesh!

— Nuk ftohem, o ma! Ja, doli dielli!

Qielli ishte i kthjellët, si xham i larë me pluhur sapuni. Dielli shkëlqente sa të vriste sytë, po ngrohtësia e tij s'mbërrinte gjer në tokë.

— Brenda, thashë!

Donte, s'donte, Juli u ngjit sipër buzëvarur.

Ishte fëmjë i dëgjueshëm, por dhe sedërtar. E mbante inatin përbrenda.

Sara Vojniku e kuptoi dhe iu dhimbs.

— Vish xhupin dhe dorashkat, — i tha të birit, — dhe hajde të bëjmë një njeri prej dëbore, si ata që kemi parë në filmat me kartona.

Juli përplasi duart nga gëzimi dhe pas pesë minutash ata ishin prapë në oborr, mes borës që kërciste si lëvozhgë veze.

Të dy bashkë nisën ta mblidhnin borën në një vend. Pastaj Sara e ngjeshi me duar dhe pas pak u bë një tog i rrumbullakët, i ngjashëm me fuçinë prej druri ku gjyshi mbante verën. Juli vinte rrotull, duke e ledhatuar me doçkat e tij.

— Tani do t'i bëjmë kokën, — tha Sara. Në vend të syve i vuri dy komça të mëdha, një lugë e vjetër shërbeu për hundën dhe, pasi i vunë në gojë një çibuk që e morën te bufeya, nënë e bir u tërhoqën mbrapa, për të soditur veprën e tyre. Juli sa s'fluturonte. Iu kap së ëmës për fustani e, duke ia pushtuar këmbët me krahët e tij të vegjël, cicëronte:

— Bravo, mami, bravo, mami!

\*  
\*      \*

Mbrëmja ishte si riprodhim i zbehtë i një nate polare. Bardhësia e borës, shpërndante një

ndriçim të plumbtë, të vrarë. Sara, me një mijë e një mundime, e kishte ngjitur në verandë njeriun prej bore, sepse Juli qe mekur nga të qarët. Nuk mund ta linte vetëm atje në oborr burrin prej bore, se ai do të vdiste nga frika e të ftohtët. Aty në verandë, veshur me palto e mbështjellë me shallet e leshta, nënë e bir kishin ndenjor gjer vonë, dhe darkën aty e kishin ngrënë. Pastaj Julin e kishte zënë gjumi në prerin e së ëmës.

E zhveshi, e vuri në shtratin e tij të vogël dhe, duke i rregulluar velenxën mbi jorgan, buzëqeshi me dhimbje. Që para dy vjetësh e gjysmë, kur kishte vdekur pas një aksidenti automobilistik Sandër Vojniku, i ati, Juli nuk pronte të flinte me të ëmën. Befas ai e kishte ndër veten të rritur.

Veshi këmishënatën dhe hyri në shtroja. Çarçafët qenë të akullt dhe krahët iu mbushën me dridhma. Dikur, në netët e tilla, ajo e pushtonte fort Sandrin dhe kështu i zinte gjumi. U mblodh grusht dhe mbuloi edhe kokën. Pas disa minutash u ngroh disi. Zbuloi kryet dhe u kthye në ijë. Klithi me tmerr. Po menjëherë u qetësua. Në krah të majtë të saj, aty ku dikur flinte Sandri, qe shtrirë një hije disi e çuditshme, që luhatej nga pak. Ishte hija e njeriut prej bore.

U përpoq të flinte, por s'mundi. Për shumë

kohë pas vdekjes së Sandrit ajo vazhdonte të jetonte me kujtimin e tij. Ishte një provë sfilatëse, e shoqëruar me përlojtje të gjata e tronditje të mëdha shpirtërore. Ndaj, duke kaluar koha, përpiquej më kot ta hiqte mendjen prej tij. Me këtë përpjekje kalonte dita, po natën, në gjumë, fanitja e tij ishte e pashmangshme.

«Sara, — iu bë se foli hija, — sa kohë u bë pa të parë»....

.....

«Ishim kaq mirë, kaq të lumtur, do të bënim shumë fëmijë, Sara, të kujtohet?».

«Po.»

Hija u largua pak majtas. Sara u afrua dhe zgjati dorën drejt tij.

«Po kur të rrëmbeva? Ti ishe e lumtur dhe thoshe gjatë gjithë rrugës se s'ka gjë më të bukur sesa udhëtimi me motor.»

Sara e mbajti për një çast dorën. Ai motor ia hëngri kokën, të shkretit, një mbrëmje vere, kur e kishin lajmëruar se tri dele nga tufa e Qafës qenë të sëmura rëndë. Mjeku veterinar Sandër Vojniku kishte lënë darkën në mes, festonin përvjetorin e pestë të martesës. «Kthehem pas një ore», u kish thënë të ftuarve, kishte rrëmbyer çantën dhe për herë të parë gjatë atyre pesë vjetëve, kishte ikur nga shtëpia pa e puthur të shoqen.

«U bënë dy vjet e gjysmë që jam pajtuar me prindërit. Ata erdhën ditën e varrimit.»

«E di.»

«Nga e di?»

«Sara, unë i dëgjoj dhe i ndiej të gjitha, vetëm se nuk i shoh.»

Sara nuk foli.

«Sara, ti nuk duhet të harrosh një gjë. Jeta është e gjatë. Njeriu ka nevojë për një mbështetje. E shpirti i një njeriu të vdekur s'mund të jetë kurrsesi mbështetje. Kuptoje këtë gjë, Sara! Ti duhet të gjesh një baba për Julin, duhet të bësh shumë fëmijë, ashtu siç ëndërroje dikur.»

Pranë Sarës kishte mbetur vetëm çereku i hijes, pjesa tjetër kishte rënë nga krevati. Hëna po perëndonte, jashtë po ndiheshin hapat e ngadaltë të agimit. Sara nxori krahun jashtë krevatit dhe e pushtoi fort hijen, kishte frikë se mos ajo i ikte.

«Jo, Sandër, ju bë sikur tha, vec teje, unë s'dua të kem tjetërkënd në jetë.»

Hija qeshi:

«Eh, Sara, Sara! Bëhu realiste, po të them! Jeta vazhdon»...

Hija u zhduk. Sara klithi «Mos!». Nga xhami i dritares dallohej turbull njeriu prej bore, që dukej i heshtur dhe disi i shkujdesur, pa e vrarë mendjen fare pse nuk e pranonin në shtëpi.

Sara u ngrit si somnambul dhe hyri në banjë. Megjithëse temperatura brenda në shtëpi nuk ishte më tepër se 5 gradë, ajo takoi spinën e dushit dhe hoqi këmishënatën. Përmes ujit të ngrohtë, që rridhte nga hinka me frushullimë,

ajo soditi e preku trupin e vet lakuriq. Nuk  
kishte humbur shumë nga freskia femërore. Fun-  
dja, ajo ishte vetëm 29 vjeçe.

Dhe atë mëngjes janari Sara Vojniku e  
ndjeu veten të etur për jetë.

## FYERJA

Plakut i merreshin këmbët prej lodhjes. Ishte nisur nga fshati në mesnatë, kishte kaptuar pesë rrethe, herë më këmbë, herë me makinë, gjersa kishte mbërritur këtu. Flokëkreshpëruar, i përbaltur dhe i pahitur me pluhurin e rrugëve, ngjante si i ardhur nga visi i satanait. Ndaj, kur hyri në saletën e turizmit, të tërë i drejtuan sytë kureshtarë nga ai. Kjo zgjati vetëm një çast, pastaj ata vazhduan me pjatat e supës e të biftekut, me gotat e verës e të rakisë, duke komentuar me bulçitë e mbushura, stonaturën që krijonte plaku i pluhurosur me tërë këtë mje-

dis idilik.

Në pritje të kamerierit, e kishte ngrënë një paninë, duke e ngjyer në kripë dhe mendjen vazhdonte ta mbante te nipi ushtar. Ai qenkësh zënë aty në repart me një ushtar tjetër dhe plaku, që tok me nipin qenë të vetmit që kishin shpëtuar gjallë nga orteku para katër vjetësh, shaloi kalin e merakut e u nis për udhë.



Vërtet, kjo dynja qenka halle-halle, po halli i nipit, e i mbesës mos të zëntë kurrë. Për ata të uruar të dhemb shumë më tepër se për vete.

Plaku e bëri përshesh supën dhe nisi të hante me të dy bulçitë. Duhani, që e kishte nderzur në fshat dhe e kishte fikur këtu, në turizëm, çuditërisht ia nxiste edhe më shumë urinë!

Sytë i mbante në pjatë, kurse mendjen atje lart, në repartin e nipit, ku, pasi errej, nuk mund të afroheshe. Do ta gdhinte si do ta gdhinte plaku këtë natë, ai që kish parë aq në jetën e vet 81-vjeçare...

Nuk e kishte mbaruar ende supën, kur kamerieri i erdhi në tryezë, i bëri një përkulje teatrore dhe i pëshpëriti:

— Xhaje, gjej ndonjë vend tjetër, se do të ulet ky çifti!

Në shpirt të plakut regëtiu një shkëndijë inati e mëllef, po kur mendoi nipin, që ishte fejuar para katër muajsh, nuk u ndie. U ngrit duke mbajtur pjatat në dorë dhe po vështronte andej-kënde me shpresën e kotë për të gjetur një tryezë të lirë.

Në shpirt i brufulloi diçka, si zog i trembur, por plaku nuk e dha veten. U pendua që ishte ulur për të ngrënë bukë. Më mirë do të kishte bërë të ishte shtrirë menjëherë në krevat, t'i ishte dhënë gjumit e të priste ditën e re.

Nga mendimet e përmendi zëri i ca djelmoshave, jo më shumë se 20-22 vjeç, që po e ftonin te tryeza e tyre. Plaku u ul duke falënderuar

më dorën në zemër. Njëri prej tyre i mbushi një gotë me verë dhe plaku e ngriti duke u uruar me gjithë shpirt shëndet e mbarësi. Djelmoshat dukeshin çakërrqejf, po kjo nuk e pengonte mirësinë e tyre. Ngjanin paksa më mendjen përmbi flokët e paqethur, po s'prishte punë. Në fund të fundit, ata i patën bërë nder.

— Ç'thotë bujqësia, xhaje? Mirë jeni me të mbjellat e të korrat? — po e pyeste njëri nga ata, sytë e të cilit ngjanin si dy rruaza të ngjitura mbi fytyrë.

— Boll mirë! — përgjigjej plaku me gojën plot e dorën në zemër.

Ata seç çuquritën kokë më kokë dhe pastaj ia plasën gazit. Plakut i brufulloi përsëri ai zogu i trembur, por vetëm sa vuri buzën në gaz. Të rinj janë, e kanë edhe vaktin edhe ngenë për shakara, mendoi ai dhe mendja i rendi përsëri te nipi ushtar.

— Xhaje, a ta dredh një cigare?

— Dridhe, bir! — Dorën në zemër plaku.

— Hajvan! — u hodh ai me sytë e ngjitur në fytyrë. — Paketa në tavolinë dhe gruaja në krevat s'pyeten kurrë!

Përsëri plasi gazi. Përsëri zogu rrahu krahet, këtë herë më me forcë. Përsëri plaku buzëqeshi. Nga tryeza pranë dikush u hodhi djemve një vështrim të rreptë.

— Ja, xhaja e di mirë këtë, apo jo, plako? Na thuaj të drejtën, e pyet ti plakën kur e ke në krevat?

Kësaj here gazi vazhdoi më me forcë e rrëmujë, sikur krakërrinte një tufë me gala.

Plaku u vrenjt, plaku u rrudh, plaku u plagos. Zëri i kishte marrë arratinë. Në atë tryezë tanimë s'qenë 4-5 kokoroçë gjysmë të dehur. Saleta e turizmit qe zhdukur fare nga faqja e dheut. Tani plaku po shihte vetëm bardhësi, bardhësi rrëqethëse, që të vriste. Ja, ai po zgjat duart e nën mbeturinat e trarëve e të gurëve kërkon trupin pa jetë të Martës së tij, gruas së tij, me të cilën jetuan plot 50 vjet si dy të por-sadashuruar. Plaku s'besonte në zot e perëndi, po përgojimin e të vdekurve e quante mëkat, krim. Ata djelmoshat vërtet nuk dinin gjë për Martën e tij, për bijtë, nuset, nipat e mbesat e tij. Por ata kishin gjyshe, kishin nëna, kishin motra. Ata nuk e kuptonin dot se në këtë mënyrë fyenin për së mbari prindërit e të afërmit e tyre...

— Hë, xhaje, na thuaj! Ti dukesh që në sy! Të zien gjaku, xhaje! Ha, ha, ha...

Tani s'qe zog. Tani një shqiponjë rrahu krahet me zemërim dhe rrëmbeu një nga shishet e verës që sapo qe nisur. Qetë-qetë, plaku nisi ta derdhte lëngun e kuq mbi leshrat e paqethura të kokoroçit me dy rruazat e ngjitura në fytyrë. Vera rridhte në flokët, në sytë, në xhakaventon, në pantallonat. Tani ai ngjante i pshurrur fund e krye.

Në lokal nuk bëzante as miza. Të gjithë i kishin drejtuar sytë andej dhe po prisnin me ze-

mër të ngrirë të ngjante hataja. Kamerierit i kishte ngrirë në cep të buzës gazi prej lajktari.

Pasi shishja mbaroi krejt, plaku e kapi djaloshin për flokësh dhe ia rrsi hundët në pjtatën me meze. Pastaj u ngrit dalëngadalë, si një mal i gurtë, dhe eci drejt kamerierit. Nxori nga portofoli një 25-lekëshe, e mblodhi shuk dhe ia flaku te këmbët. Me hap të shtruar u nis drejt daljes, qëndroi për një çast dhe e vështroi me përbuzje kamerierin, që ishte ulur për të marrë parat:

— Mbaje kusurin! — i tha.

Dhe duke dalë, ndjeu pas vetes vështrimet si prej fajtori të çiftit që e kishte ngritur plakun nga tryeza...

## MIRËNJOHJA E ÇIZMEVE

1

Gjatë atyre dhjetë ditëve të para të burgimit ai ishte plakur 20 vjet më tepër. Ishte 45 vjeç dhe shumicën e jetës e kishte shkuar mirë, po të krahasohej me disa nga bashkëfshatarët më të këputur. Një fotograf në ato anë vlente më shumë dhe se sheqeri e kafja, që vinin përtej detit. Zanatin e kishte marrë në Francë dhe aty shkonte herë pas here, jo vetëm për të blerë materiale, por edhe për të punuar. Galia kishte peizazhe shumë të bukura. Atë që kishte lënë mangët përrëndia, e kishte plotësuar bukur mirë dora e njeriut. Kartolinat me pamje nga Franca ishin një burim i konsiderueshëm fitimi, sepse banorët e atyre anëve, ndonëse në gjendje financiare për të mos u pasur zili, të bukurën e donin dhe paganin për të.

Gjersa kishte ardhur lufta, duke sjellë me vete sikletet, vajet dhe frikën.

Dasmat u harruan dhe ai falimentoi. Më saktë, hoqi dorë. Aparatin dhe solucionet i la në një cep të dhomës së gjumit, kurse trikëmbëshin e flaku në plevicë.

Një mbrëmje vjeshte, kur shiu luante vallen pognishte mbi tjegullat e shtëpisë, kishte trokitur dy herë porta. Ai kishte lënë mënjanë «Të mjerët» e Hygoit dhe u kishte hapur derën partizanëve. Po atë natë kishte bërë dhe fotografinë e parë të luftës. Ajo duhej për një letërnjoftim të rremë. Kështu kishte thënë komisari, duke iu përgjigjur një pyetjeje të pabërë të fotografit.

Pastaj kishte nxjerrë dhe fotografi të tjera. Madje kishte rinisur të endej fshatrave e maleve; fotografonte grupe partizanësh, shtëpi të djegura, gryka lumenjsh. Pas lufte këto fotografi do të jenë dëshmi të heroizmit partizan. Kështu thoshte shpesh komisari, duke iu përgjigjur pyetjeve të pabëra të fotografit.

Nga gjithë këto u nda një mëngjes të papërsëritshëm marsi. Ishte koha kur toka merrte frymë me tërë mushkëritë dhe kumbullat qenë veshur me lule. Gjithmonë çohet herët nga shtrojat. Kur moti që pa shi, e pinte kafën te lëmi i vogël poshtë shtëpisë, mbi detin blu. Edhe pse tuberkulozi e sfiliste, cigaren vazhdonte ta pinte. Atë ditë s'arriti as ta ndizte. Gjermanët nuk ia zgjatën; i pari i tyre i foli frëngjisht dhe ai e mori me mend se si do t'i ventë filli pas kësaj. Veç «Manifestit» dhe ca librave të tjerë në gju-

hën frënge, mes të cilëve edhe poezitë e Majakovskit, kontrolli nuk nxori gjë në dritë. Po dhe këto qenë mjaft. Në fund të fundit, ata nuk qenë ngjitur për piknik gjer në atë kodër që ngrihej mbi detin dhe dukej sikur e sundonte plotësisht atë. Nazistët, katër qenë gjithsej, e futën mes tyre dhe zbritën monopazit. As ai, as e shoqja nuk thanë dot një fjalë. Vetëm se u panë për një çast sy ndër sy. Sy ndër sy qenë parë edhe atë pasdite të largët, shumë të largët pranvere.

Qelia s'ishte aq e tmerrshme sa e tregonin. Muret vinin era gëlqere dhe kjo e mbyste pak kundërmimin e ajrit të rëndë. Qelitë e burgjeve i njihnte vetëm nga sa kishte lexuar. Muret këtu s'kishin asnjë mbishkrim, por edhe ai s'kishte aspak ndërmend që të gërvishte aty emrin e vet. Librat sentimentalë s'i kishte prekur kurrë me dorë.

E donte shumë jetën, por këto dy-tri ditët e fundit kishte rënë në një apati të pashpjegueshme. Ende s'e kishin marrë në pyetje. Por edhe kur të vinte dita, as do të fliste, as do të reagoonte fare. Ai kishte bërë diçka në jetë, kishte mbajtur gjallë e edukuar gjashtë fëmijë që, të paktën, do t'ia përkujtonin përvjetorët e vdekjes.

U përmend nga hapja e portës së rëndë. Brenda hyri një djalë 20-22-vjeçar, i bukur, mustaqelli e trupimët, si ketër.

Fotografi lëvizi nga vendi dhe e vështroi me sytë pyetës.

— Qentë! — shau djaloshi, — më zunë më të pabesë, por kam për t'u lënë glasën! S'më njohin mirë ata, jooo! Tani do ta mësojnë se kush është Rremë Haruni!

2

Fotografi s'kishte shumë kohë që qe kthyer nga kampi i përqendrimit i Prishtinës. Andej kishte vuajtur shumë dhe trupi i tij i sëmure mezi e kishte përbulluar tmerrin e vazhdueshëm. Dhe, kur ende lëngonte në shtrat e s'e kishte marrë mirë veten nga ato vite ferri, e arrestuan përveri, për tradhti të lartë ndaj atdheut. Dhe ky arrestim ishte për fotografimin si një pushkatin, sepse ai për këtë shtet të ri e kishte vënë sa herë kokën në torbë dhe shpëtimi nga vdekja, ashtu si dhe për shumë pjesëmarrës të tjerë të Lëvizjes, nuk ishte tjetër, veçse një mrekulli e rastit. Shteti, që po mbushte vitin e katërt të çlirimit, kishte halle të shumta, ashtu si një familje e re, që e nis jetën vetëm me rrobat e trupit. Fotografi i shkretë shtrydhte trutë për të parë se ku ia kishte bërë me hile shtetit, po ngado që e zinte veten, duart i mbeteshin të pastra.

Qelia ku e kishin rrasur i ngjante si një kuvli për harabela, aq e vogël ishte. Kurse akuza ishte sa absurde, aq dhe e rëndë, e tmerrshme. Fotografi paskësh spiunuar te gjermanët kryetar



e këshillit nacionalçlirimtar të krahinës bashkë me një partizan, kunat i fotografit, të cilët i kishin vrarë në pusi. Kjo kishte ngjarë në shtator të '44-s, kurse fotografi në atë kohë vuante në Prishtinë.

Ai u gëzua kur mes grupit të hetuesve pa edhe Rremë Harunin. Edhe po të mos lirohej, të paktën do të kishte një krah ku të mbështetej. Sepse Rrema e njihte mirë. Ndaj një ditë, kur po e merrnin në pyetje, fotografi nuk duroi dhe iu drejtua kapitenit:

— Nuk po më njeh, o Rremë Haruni?

Rrema e vështroi egër dhe i foli prerë:

— I pandehur, përgjigjju vetëm pyetjeve që të bëhen!

Sytë e fotografit u shqyen nga habia. Vetëm katër vjet kishin kaluar, dreqi e mori! Ai vetë s'kishte ndryshuar fare në fytyrë, as Rrema. A mund të harrohet një person, të cilin e sheh sa mërzitësh, 70 ditë e net të tëra? Pastaj çizmet...

Historia e çizmeve nuk mund të mos i kujtohej. Kur kishin qenë në qelinë e gjermanit, Rrema për disa ditë me radhë i kishte hetuar mirë e mirë mjediset e komandaturës. Për fat, nevojtorja ishte në katin e parë, kurse qelia në të dytin. Ndaj një mbrëmje ai i kishte thënë fotografit:

— Usta, bëhu i sëmurë, të të marr në krahë e të zbresim poshtë! Aty pastaj ia mbathim!

— Jo, mor bir, — buzëqeshi ai, — unë ve-

tëm të prish punë, kështu si jam katandisur, gjysmë njeriu. Po dëgjo, opingat i paske për ibret të zotit, ato do të të pengojnë... Na, merr çizmet e mia, s'kam as një gjysmë viti që i kam mbathur.

Qenë një palë çizme lustrafin, çizme oficeri, që atij ia kishte dhuruar komisar i batalionit të pestë.

**Rrema** ndenji për një çast mëdyshas, pastaj **shpejt e shpejt** hoqi opingat e veshi çizmet. I **përplasi këmbët** në tokë.

— Ta paça borxh, usta! — foli. — Ta shpërblefsha në Shqipërinë e lirë!

Të nesërmen në mëngjes Rremë Harunin e kishte përpirë dheu.

### 3

Nuk thonë kot që hanxhiu me qiraxhiun piqen. Pa kaluar tre muaj nga burgimi i tij, e thirrën në drejtorinë e burgut dhe aty, një major i ardhur nga Tirana, i komunikoi pafajësinë dhe i tha se nesër duhej të qe patjetër në kryeqytet e të dëshmonte në një gjyq kundër armiqve të Partisë e të popullit.

Nuk u habit kur mes të akuzuarve pa edhe Rremë Harunin. E vërteta vonon, po nuk harron. Rrema ishte shfityruar, si një fotografi e stampuar keq. Koka e qethur i ngjante me një dardhë të vockël, kurse mustaqet e tij të mëdha,

dashur padashur, të krijonin një ndjesi humori. Të akuzuarit paskëshin shumë gjynahe për të larë. Në gjyq përmendeshin pa të keq emra udhëheqësish të shtetit, planet që qenë bërë për zhdukjen e tyre; çemërime dhe emërime në poste të rëndësishme. Fotografi pas kaq vitesh po i ndiente përsëri përmasat e vërteta të jetës. Jeta e meriton të jetohet edhe në çastet kur qëndron e varur në fije të perit, madje edhe në çastet kur njeriu rrugëton për në Had. Është e rëndësishme që njeriu, duke vdekur, të lindet përsëri.

Kur ai po i afrohej podiumit, Rremë Haruni kërceu në këmbë dhe, i mbajtur për krahësh nga dy policë, nisi të çirrej si i marrë:

— Usta! Ti më njeh mirë mua! Fol, usta, tregoju kush jam unë! Mos e harro burgun që bëmë bashkë! Jam i pafajshëm, usta!

Ustai nuk mund ta vinte dorën në zjarr për fajësinë e Rremës, po ashtu dhe për pafajësinë. Pavarësisht nga rrethanat e dy takimeve të tyre. Si të vetmen provë fajësie ai konsideronte ato çizmet që ish-kapiteni mbante ende veshur dhe që ende s'e kishin humbur lustrën. Kuptohet, nuk qenë çizmet që i pati dhënë fotografi, por qenë çizme, gjithsesi...

## POLIGLOTI

*(Karikaturë miqësore dhe jomiqësore)*

Kur hyra së pari në sallën shkencore të bibliotekës, më pushtoi mendimi se brenda asaj kuadrature kaba, ku e kafta e orendive dhe e blerta e mureve grindeshin në mes tyre për të nënshtruar njëra-tjetrën, u bëkej puna e madhe. Shkrimtarë, akademikë, pedagogë, veteranë i jepeshin asaj salle me gëlthësinë e dashmorëve të marrë dhe mokrat e trurit bluamin shkencë, letrësi, art, mobilizim. Në këtë tempull, që vinte era letër, llak, parfum e djersë, unë hyra me hap të druajtur e me mëdyshjen e besimtarit të devotshëm, që po përgatitet të kryejë një mëkat. Por ama hyra! Gjithë puna ishte të veja qysh më shtatë të mëngjesit në bibliotekë, të lija çantën a një bllok të trashë mbi tryezë e pastaj t'ia mbathja nga të më tekej e të kthehesha kur të më donte qejfi.

Në atë sallë hynin e dilnin turkilloj njerëzish, që nga studentet lozonjare e gjer te ca fytyra të fishkura e antipatike, që nuk doje t'ua

shihje për së dyti binanë e kërrusur nga vitet. Shumica prej nesh, frekuentuesve, qemë të për-hershëm. Rrënim goxha kohë në bibliotekë dhe, kur ndonjëri s'dulkej për një kohë të gjatë, pasi kthehej, unë e vëzhgoja me kujdes, për të marrë vesh arsyen e mungesës: kishte qenë me leje, sëmurë, apo jashtë shtetit.

Me kalimin e kohës tryeza e tretë e mesitit të parë të krahut të djathtë kaloi në «juridik-sionin» tim. Madje gati gjithmonë, kur largohesha mbrëmjeve, unë e lija aty çantën dhe të nesërmen në mëngjes nuk sikletosesha se mos më bëhej vonë për në punë, siç më ndodhte më parë.

Pas meje, çdo pasdite, rrinte gjithmonë një burrë rreth 42 vjeç, trupi i të cilit kishte mbetur përjetësisht i anuar nga e djathta, a thua se dikush e kishte goditur me shkëlqim në ijë dhe ia kishte katranosur simetrinë. Ishte tip studioz dhe poliglott. Këtë ma vërtetonin librat e shumtë në gjuhën frënge, polake, ruse, gjermane, arabe e në gjuhën e drejt me të birin. Zhytej në lexim dhe s'kishte burrë nëne që ia trazonte përqendrimit. As tërmeti nuk mund ta largonte atë nga mbretëria e shkronjave dhe e hieroglifëve!

Një herë, kur po pija duhan në korridor, ai m'u afrua dhe me shumë mirësjellje kërkoi t'i ndizja cigaren. Unë, që isha mbështetur te parmakun, u drejtova dhe nxora me të shpejtë çakmakun. Më falënderoi me një zë aq të ëmbël, që mua më ngjau se më foli në esperanto.

Koha ecte. Salla shkencore, si një grua e duruar dhe pjellore, lindte vazhdimisht romane, novela, ligje ekonomike, artikuj studimorë e problemorë. Mes këtij popullimi fjalëpak e punëshumë, poliglotti im ishte si jashtëtokësorët e Vornezhit. S'ma merrte mendja ta kishin zënë edhe atë dhimbjet e lindjes, sepse ai as shkruante, as mbante shënime; kurrë nuk i pashë qoftë dhe një skedë mbi tryezë. Nga dita në ditë kureshtja më shtohet dhe më shumë. Ajo më gërryente si një krimb dhe më e keqja ishte se unë nuk mund ta ftilloja për dy arsye: e para që se ai nuk më linte asnjë shtegth për hamendje dhe e dyta: më dukej absurde ta pyesja, ashtu të panjohur siç ishim. Sebepi i ndezjes së cigares ishte një hiç. Ai se nga kishte gjetur një çakmak të bukur me magnet.

Nuk thonë kot «*fati vonon, por s'harron*». Në redaksi na erdhi një letër nga Hamburgu, që duhej përkthyer. Menjëherë më shkoi mendja te komshiu im dhe pasdite mezi prita ta takoja. Si gjithmonë, e gjeta të struktur pas vandakut me libra. Më priti buzagaz. Mora zemër dhe ia shpjegova me dy fjalë hallin që kisha. Më dëgjoi duke tundur kokën, pa e prerë buzëqeshjen. Madje i zgjati edhe ca buzët në drejtim të veshëve dhe më tha:

— Posi, me gjithë qejf! Vetëm se na pengon një hollësi e vogël.

Unë ngrita supet.

— Puna është, — vazhdoi ai, — se unë nuk di asnjë gjuhë të huaj.

— Si?!

— Kështu! — ngriti dhe ai supet dhe hapi duart.

— Po mirë, po gjithë këta libra që lexoni përditë?

— Aha, ashtu kot! Më tërheq larmia e stileve të gërmave!...

## PËR TË VDEKUR I NGOPUR

Në jetë kujt do i ndodhin gjëra nga më të guditshmet. Nisesh për diku dhe përfundon diku tjetër, ecën në shëtitore, shkel shtrembër dhe thyen këmbën, nisesh për tek e dashura me autobus dhe befash e kupton se më kollaj e më shpejt do të mbërrije tek ajo po t'u hipje këmbëve. ... Janë aq të shumta paradokset, sa ngandonjëherë të mbushet mendja se vetë jeta është paradoks.

Por ama, një e vërtetë që s'e tund asgjë është edhe kjo: jetën e bëjnë njerëzit. Në njëfarë mënyre, njerëzit ngjajnë me drurët. Dhe jo çdo dru bën zjarr të mirë, pavarësisht se të gjithë digjen.

Ai mëngjes i murrëtyer dhjetori më ka ngehur në mend dhe e kujtoj edhe sot e kësaj dite, siç kujtohem shpesh për dhëmballën e prishur, kur ajo nis të na dhembë.

Tek po nxitoja për në punë dhe më dilte para sysh shefi, që e vërtiste sahatin në gishta si tepsije, (e kisha shkelur orarin 10 minuta), i



mbajta këmbët para hotel «Drinit». Nja katër-  
-pesë njerëz të moshave të ndryshme qenë mble-  
dhur rreth një burri të shtrirë përtokë dhe po  
gajaseshin pa e çarë kokën për shiun që ishte  
shtruar vendshe. U afrova. «Viktima» duhej ta  
kishte gdhirë jashtë atë natë, po dukej se s'bë-  
hej fort merak për këtë. I zhgërryer, tërë ujë e  
baltë, me pantallona të shkopsitura e kravatën  
të liruar gjer në zgrip, me një ngërdheshje qe-  
sharake në fytyrë, ai mendohej tu përgjigjej  
pyetjeve të të tjerëve, por s'artikulonte gjë tjetër  
veç një hungërimë prej derri të përgjumur. Ish-  
te Lamçe Binoja.

Me të isha njohur një natë më parë, në ca  
rrethana krejt të zakonshme. Hyra në restorant  
«Drini» dhe po kërkoja më kot vend të ulësja,  
kur Lamçja, burrë rreth të 50-ve, më ftoi me  
dorë. Ishte vetëm, në tryezën e mbushur me  
pjata plot e të boshatisura, si dhe me ca shishe  
verë «Reisling». Për një çast ngurrova, druhesha  
se mos ai qe me të tjerë, por, gjersa më ftoi  
vetë, u ula.

Atij i ndriti fytyra. Më zgjati paketën «Stil»  
dhe, ndërsa po më ndizte cigaren, më pyeti:

— Nga të kemi?

— Nga Himara.

— Ah, Himara! Vend i mirë goxha. Më kanë  
thënë, vetë nuk kam mundur të shkoj.

Ndërkohë erdhi kamerieri. Porosita një shni-  
cel dhe një birrë.

— Merr edhe një dopio raki! — u hodh  
Lamçja.

— Falemnderit, — i thashë, — po boll e  
kam një birrë.

— Merre, de! — nguli këmbë, — Të qeras  
unë!

Më kërceu delli:

— Ju e bëtë tuajën: më pranuat të ulem.  
S'është nevoja për asgjësend tjetër.

— Merre! Hë, të lutem!

Vetëm atëherë e kuptova se ai qe gjysmë i  
dehur. Megjithatë rakinë nuk ia pranova. Po-  
rosia erdhi shpejt dhe nisa ta copëtoja shnicelin  
me thikë.

— Ç'punë bën?

— Student, — e gënjeva.

— E po mirë, Dëgjo, se të kam si djalin  
tim. Kot, sa për muhabet, do të të tregoj diçka.  
Të vlen edhe ty. Njeriu, sa rron, mëson, apo  
jo?

Mbushi gotën, piu gjysmën dhe vazhdoi:

— Jam 52 vjeç, punoj llogaritar në degën  
e karburanteve. Kam një shtëpi si vilë, me ka-  
tër dhoma e një kuzhinë, kam një bahçe të mre-  
kullueshme dhe një pjergull që më nderon për-  
vit. Si i kam bërë gjithë këto? Me punë, por  
edhe me kursimet e mia. Rrogën s'e kam kushe-  
di se çfarë, gruaja, po ashtu. Tërë jetën kam  
qenë njeri i rregullt, as klubeve s'kam hyrë dhe,  
edhe për shpenzimin më të vogël, i kam rënë

lapsit 20 herë, pa e kam bërë. Shih ç'më ndodh në shtëpi: Grindem e bëj sherr edhe për dhjetë qindarka. Një djalë të vetëm kam, e dua si dritën e syrit, ama hesapi është hesap. Në krye të gjashtë muajve më kërkon nga një palë pantallona; s'ka faj, nxënës shkollë është dhe i fërkohen në barkë. Unë i them gruas t'ia arnojë, por a pranon ajo?! «Një djalë kemi, — thotë, — nuk e çoj në shkollë me arna unë! Mirë, moj, mirë, por unë në moshën 25 vjeç qepa për herë të parë pantallona të reja. Deri atëherë sajoja ato të babait... Para ca ditësh më kërkoi xhakovovento nga ato 6-mijëlekëshet.

Heshti, e zbrazi gotën dhe e mbushi prapë, nderi dhe një cigare. Gromsiu një herë, pastaj iu hap goja për gjumë.

— Kështu, që the ti! I vinte zor djalit të shkonte në shkollë me xhaketën time të vjetër. S'kishte faj, tani i jap të drejtë. Njeriut ngado-njëherë iu dashka përplasur dikur koka që të vijë në vete. Unë s'jam kurnac, por as dorëshpuar s'mund të jem. Në fund të fundit, kush do t'i marrë këto para? Patjetër djali. Kështu mendoja deri dje. E di ç'më bëri vaki dje?

Unë ngrita supet:

— Dje u nisa për këtu. U lashë në shtëpi para, aq sa për tri ditë që do të rrija në Tiranë, asnjë qindarkë më tepër. Paratë më pëlqen t'i mbaj me vete, më mbushet xhepi, e ndiej veten tamam burrë... Që ta ngas llafin, treni u

vonua shumë rrugës dhe, sa erdha, sa mbarova punë, në ministri, vajti ora 4 pasdite, Hëngra një pite dhe zura vend në hotel, u shtriva pak sa të merrja veten, por do ti që më doli gjumi më 9 të darkës! U çova dhe zbrita këtu të haja gjësend. Mirëpo, kur pashë se një pjatë bënte 90 lekë, u tmerrova. «S'kam aq para sa t'i hedh kuturu», i thashë kamerierit. Dola e prodha në lokale të tjera; do ti që veç lokaleve të shtrenjta s'gjeta as në një vend tjetër. Tani, unë një herë në pesë vjet vij në Tiranë, nga t'i di unë se ku janë restorantet? Pashë ç'pashë, u ktheva në hotel dhe u shtriva. Po s'thonë kot që, kur e ke barkun bosh, sheh shumë ëndrra. Ajo që pashë unë, s'qe ëndërr, por makth. Pata një gjysh që, nga që nuk e kam njohur, e dua fort. I kam marrë emrin. Që the ti, — brr, tani që e kujtoj më zë tartakuti, — m'u fanit ai në ëndërr. Ishte diku në qiell. «Kam ardhur të të marr, — më tha, «Lërmë këtu, o gjysh! — i thashë unë, — kam grua, kam djalë, shtëpi... Mirë jam këtu!». «Nuk je fare mirë! — m'u përgjigj i hakërryer, duke nxjerrë zjarr nga goja, — dhe as ke për t'i gëzuar gjatë ato, o budalla! Ke grua, ke shtëpi, por s'ke as miq e as shokë. Me kurrnacërinë tënde na tumpërove fisin. E ke shtrenguar rripin si fakir dhe s'e kupton që lumturia e djalit është edhe lumturia jote... Prandaj po të marr, sepse ti, si në tokë, si në qiell, njëlloj je. Nuk e jeton jetën!».

U zgjova i tromaksur dhe tërë natën s'vura gjumë në sy. Fjalët e gjyshit më rrihnin si çekan gjithë trupin. Kështu që e vendosa: Në djall të venë të gjitha! Unë dua të vdes i ngopur! Ja, gëzuar!

Eh, janë aq të shumta paradokset, sa nganjëherë të mbushet mendja se vetë jeta është paradoks.

## NJË NJERI QË S'DUA T'IA PËRMEND EMRIN

Ndonëse dy vjet e gjysmë e kam marrë rrogën për të bërë humor, — sepse e tillë ishte natyra e revistës ku punoja, — humor të mirëfilltë nuk kam bërë kurrë. Tërë humori im qenë ato 3-4 shkrime që i dorëzoja çdo dy javë shefit dhe që s'para bënin njeri të vinte buzën në gaz.

Historia që do të tregoj më poshtë, besoj se do të lakmohej nga ndonjë shkrimtar humorist. E gatuar nga duart e një ustai, ndoshta ajo do të dilte edhe një kryevepër, kurse unë jam i ndërgjegjshëm, një këmborë të tillë nuk e tund dot. Pra, le të më falë letërsia shqipe dhe lexuesit që, për fajin tim, do të kenë një kryevepër më pak!

Ai njeri më është neveritur qysh tetë vjet më parë, kur unë mbarova shkollën e mesme dhe fillova si punëtor i ngarkim-shkarkimit në kooperativë. Në fillim u mërzita e bëra fjalë me tim atë, i cili, mjek i zoti e burrë i nderuar në tërë Bregdetin, s'e kishte vështirë të më gjente

një punë më të mirë. Po mëria ime zgjati vetëm javën e parë, se pastaj puna më hyri në qejf. Tek hidhja në kurriz thasët gjysmëkuintalësh të çimentos apo ngarkoja «ZIS»-in me rërë, më dukej se çoj isha edhe unë, e nxirrja me djersë bukën time dhe ajo dopioja e uzos çdo ditë pas punës, tok me tre punëtorët e tjerë, më takonte plotësisht.

M'u neverit ai njeri, sepse gjithmonë i fuste hundët aty ku nuk i takonte. Gjithandej hiqej si zot, paçka se s'kishte burrë nëne që ta merrte vesh se çfarë pune bënte pikërisht, që firmoste çdo pesëmbëdhjetëditësh një bordero të mirë. Siç kishte fytyrën, ashtu duhej ta kishte edhe shpirtin, sterrë. Një trup shulak, me plot rru-dha horizontale në ballë, a thua se perëndia s'qe dakord që ajo qenie të dilte në dritë dhe ia kishte shtyrë me plot forcë e inat kokën poshtë. Kur bërtiste në mënyrë parimore, qafa i tendosej dhe i shquheshin qartë kanalet e rru-dhave, të holla e të bardha si karta e cigares. Nuk mund ta shpjegoje se çfarë i kishte zili dielli fytyrës së tij, që ia dhuronte pa kursim rrezet e arta. Dikur atij i pati humbur tesera dhe për këtë arsye e kishin përjashtuar nga Partia, por, pasi kishin kaluar nja dy vjet, qe rikthyer përsëri. Ai kishte dhuntitë e jashtëzakonshme që të ngjitej si mastiçi pas të tjerëve, kup-tohet, jo dokujtdo, por kryetarit të komitetit, sekretarit të Partisë të qytetit, kryetarit të koo-

perativës. Dhe ata, për çudi e pranonin. Ashtu siç pranon çdo njeri hijen e vet...

Vitet e fundit në qytetin tonë qenë regjistruar ca temperatura të papara prej shekujsh. Në ditët e verës ishte e zakonshme që termometri të tregonte 40 gradë celcius nën hije. Njerëzit, në kundërshtim me vendimin që kishin nënshkruar shefi i policisë dhe kryetari i qytetit, eënin rrugëve veshur vetëm me kanotierë. Edhe vetë uji i detit përvëlonte. Kurse ai, të cilit nuk dua t'ia përmend emrin, se më zë alergjia, nuk e hoqi një herë xhaketën nga trupi. Sepse as kryetari i kooperativës nuk e kishte hequr, gati dhjetë vjet rresht, xhaketën. Ia imponote posti këtë, apo krizat e herëpashershme të astmës bronkiale, nuk e di. E përmenda këtë hollësi, sepse xhaketa e kryetarit është sebepe i historisë që premtova të rrëfej.

Një ditë prej ditësh kryetari i kooperativës u transferua. Puna e tij bëri që ai të ngjitej më lart, kurse personazhi im nisi fill të bënte rikonjicionin rreth figurës së kryetarit të ri.

Kryetari i ri ishte i urtë, vinte i shëndetshëm e i fortë, si një ka. I mirë si ai. Por kishte vetëm një huq: xhaketën mezi e mbante veshur edhe në dimër.

Kështu që u detyrua edhe personazhi im ta hiqte xhaketën. Sepse, ngaqë borderonë e firmoste vazhdimisht në kooperativë, kuptohet që shtranicën e kohës rrinte pas kryetarit të saj.



Ishin ato ditët e kiametit, kur toka e qielli kishin marrë zjarr. Njerëzia, dmth. kooperativistët, dilyn në punë qysh më katër të mëngjesit, e mbaronin normën dhe pastaj, deri më tetë të darkës rrinin në plazh. Vetëm kështu mund t'i shpëtonin ca shikletit të vapës.

Krahët e tij kishin një ngjyrë meiti, mu si ngjyra e asaj pjese të trupit që njeriu normal nuk ia shfaq kurrë diellit. Tek ia krahasoje me ngjyrën e zezë të fytyrës, të dukej se krahët ia kishin marrë hua ndonjë tjetri.

Pasditen e parë mishi i krahëve ishte ngjyrosur nga një purpur i mirë, që binte në sy që larg.

Pasditen e dytë ata u skuqën edhe më shumë, si një domate në fazën e tejpejjes.

Pasditen e tretë nisi t'i rripej lëkura dhe tërë natën nuk vuri gjumë në sy.

Pasditen e katërt mishi nisi t'i plasaritej dhe në mes të natës atë e nisën urgjent, me «GAZ»-in e kryetarit për në spitalin e rrethit.

Djegia ishte e gradës së dytë dhe pas dy muajsh ai doli nga spitali. Po kishte hequr picirën dhe ende ishte i hutuar. I patën marrë mish nga këmbët dhe ia kishin vënë në krahë.

Dy muaj qenë të mjaftueshëm që shokët drejtues të mësoheshin me mungesën e tij e të mos e ndienin më nevojën për ta pasur pranë.

Nga kjo gjë ai vuan më tepër se nga një ridjegje e gradës së tretë...

## PORTRET GROTESK PËR KRYETARIN E DEGËS SË FINANCËS Q. MYSHKULLIN

Ditën që Qeramundin Myshkulli mbushi plot 20 vjet si kryetar i degës së financës në NOP, i ndodhi diçka e çuditshme, që i shënoi tërë jetën e vet të mëpastajme. Gjithmonë ishte shquar si njeri praktik, që kurrë s'u besonte parandjenjave, por vetëm llogarisë. Qysh pa dalë nga shtëpia, ai e dinte se si do t'i vente filli tërë ditën. Qejf s'kishte prishur asnjëherë, me askënd. Dhe kjo ishte arsyeja kryesore që pothuajse gjysmën e jetës së tij 47-vjeçare, ai e kishte kaluar në atë zyrën e vogël në kat të dytë, përballë me zyrën e drejtorit që kishte ndërruar gjashtë herë zot, qysh kur Qeramudini kishte nisur punën.

Atë ditë, pra, pasi kyçi zyrën, (më 3 e një minutë, si përherë), dhe nxitonte drejt autobusit, Q. Myshkullit as i shkonte ndër mend se në mekanizmin e tij llogaritës ishte prishur diçka.

Ndryshe, ai ndoshta do të mundte ta parandalonte gjëmën.

Hipi në autobus dhe çau përpara që të zinte vend diku nga fundi, siç bënte gjithmonë. Kallaballëku ishte i madh dhe Qeramudini e kishte vështirë të përparonte. E kjo i krijonte një lloj asfiksie bezdisëse. Dhe, sikur asfiksia të mos mjaftonte, befas një grua klithi dhe thirri:

— Ngadalë, more shok, se na vrave!

Gjithë mirësjellje, Qeramudini u kthye nga ajo që t'i kërkonte ndjesë, kur një tjetër grua bërtiti me të madhe:

— Qyqja, më iku çorapja e re!

Dhe iu kthye Qeramudinit:

— Ku i ke sytë, mor shok? Shih se nga e vërvit çadrën!

Qeramudini u habit, sepse s'kishte çadër me vete. Sa herë që kthehej andej-këndej, gjendej dikush që goditej nga diçka e padukshme, nga diçka e fortë, që gjithsesi kishte lidhje me kryetarin e financës; ndryshe, tërë ata njerëz nuk do t'i binin në qafë kot.

Zbriti në stacionin më të parë dhe i bëri më këmbë ata 800 metra rrugë deri në shtëpi. Ishte dëshpëruar aq shumë, sa as drekë s'hëngri, po shkoj drejt e në shtrat. U zhvesh, veshi pizhamet dhe u shtri në shpinë. Mirëpo kërcëu i trembur, si të qe shtrirë mbi gjemba. Në të ndenjurat ndjeu një goditje të çuditshme, diçka që kërkonte t'i ngulej në mish me çmos. U kthye në

ijë, po prapë, s'gjeti rehat. Vetëm kur u shtri përmbys, e ndjeu veten të qetë.

Gjumin s'e kishte problem: sa mbështeste kokën në nënkresë, ai i vinte si manar dhe ja mbyllte sytë.

Më 8 e gjysmë të darkës e zgjoi gruaja. Kishte ardhur dhëndri. (Vajzën e vetme e kishin fejuar para dy muajsh me djalin e drejtorit të QRS-së). Bëri të ngrihej, por ai sikleti në të ndenjurat iu përsërit. U hodh nga krevati me një lëvizje disi të çuditshme dhe shkoi në banjë të lante sytë.

Sapo hapi rubinetin, i lindi një mendim. Ktheu dy herë çelësin te dera, mbylli mirë dritaren e banjës, pastaj i uli pizhamet gjer te kyçet e këmbëve. Mori pasqyrën dhe me mundim rrotulloi qafën, që të shihte gjësend në të ndenjurat e tij. Hiç. I erdhi shpirt në vend dhe e ngushëlloi veten se gjithçka ishte një fiksacion, i imponuar nga lodhja e atyre ditëve. (Kishin mbyllur bilancin e tremujorit.) E vuri pasqyrën në vend dhe i ngriti pantallonat. Lau fytyrën dhe, ashtu siç qe, me pizhame, shkoi të takonte dhëndrin.

Cifti i ri u ngrit më këmbë dhe Qeramudini e puthi dhëndrin në ballë. Pastaj bëri të ulej në divan, po këmbët iu ngatërruan në një mënyrë të çuditshme dhe ai desh ra. Të gjithëve u ngeci gazi në buzë, kurse kryefamiljari Myshkulli s'e desh veten. Po s'thonë kot: «Kur të vjen e mira, hapi derën»... Belbëzoi një «dreq o pu-

në, më falni!» dhe, duke u kthyer me vrull që të gjente gjyzlykët, i këputi një goditje fatale dhëndrit, në atë vend që është pika më e dobët e çdo mashkulli. Dhëndri u bë për ujë të ftohtë dhe të dyja gratë e shtëpisë rendën të merrshin me të, kurse Qeramudini rrëshqiti dhe shkoi në dhomë të gjumit.

Vonë, shumë vonë, e shoqja erdhi dhe e gjeti duke fjetur përmbys. Me thënë të drejtën, ai bënte sikur flinte, sepse s'kishte qejf të gërricej me gruan, që gjithmonë kishte pasur një lloj pushteti të çuditshëm mbi të.

— Ç'na bëre, që u bëfsh lëmsh! — iu shkreh ajo. — Na tumpërove!

Ai donte të kthehej në krah të kundërt, me shpinë nga ajo. Harroi ç'i kish ndodhur tërë atë pasdite dhe lëvizti. Gruaja bërtiti në kupë të qiellit dhe ra nga krevati.

— Mama, ç'ke? — ia pati e bija matanë derës së dhomës.

— Kam lumin që të më marrë! — shfryu ajo. — Mos t'i pafsha më sytë! Mushkë xanaxare! Hë, mushkë— iu kthye të shoqit. Rrëmbeu jashtëkun e vet, një jorgan nga musandra, hodhi në trup penuarin dhe iku të flinte në dhomën e së bijës. Duke dalë, përplasi me tërsëllimë derën pas vetes.

Atë natë Qeramudin Myshkulli e gdhui në shoqëri me lugetërit. Në mëngjes, kur po lante fytyrën, pa i tmerruar se qe thinjur i tëri. Prej tmerrit dhe merakut. E ndiente se diçka kishte

në trup, diçka si mish të huaj, po se çfarë dhe  
ku konkretisht, s'kishte zot që t'ia ffillonte.

\*  
\*      \*

Enigmën e sqaroi të nesërmen, kur vajti në  
zyrë. Karrigia s'ishte në vendin e vet dhe atij sa  
s'i ra pika. Gjunjët iu këputën, iu thyen më dysh  
dhe, për çudi, nuk ra përtokë, por u gjend ulur.  
Lëvizi dy-tri herë dhe e kuptoi se nën të ndo-  
dhej karrigia, mbi të cilën qe ulur 20 vjet rresht.  
Pas një kohe aq të gjatë nënshtrimi të bindur  
ndaj të zotit, karrigia kreu kulmin e devocionit:  
ishte bërë pjesë e kryetarit të degës së financës,  
Qeramudin Myshkullit...

## MOS JU ZËNTË DERËN!

E pata gostitur me cigare «Dunhill» e me kafe kubane, ia pata mbushur dy herë gotën e rakisë, që nga çasti i ardhjes që mbushur një orë e gjysmë dhe unë po prisja më kot që ai t'i vinte majat nga kishte thembrat.

— I lumshin duart tyt eti! Paska zier raki shumë të dashur! — tha pasi e zbrazti për së dyti gotën dhe përplasi gjuhën pas qiellzës.

— Jo, — iu përgjigja hazërxevap, i vendosur për të mos i shtënë më asnjë pikë në gotën boshe, — është raki dyqani.

— Jaaa! U bëra 50 vjeç dhe raki të tillë s'kam provuar! Po s'thonë kot: mjeku hyn dhe aty ku s'hyn dielli, — dhe më shkeli syrin me nënkuptim.

Nga bezdia dhe inati i madh që më kishte kapluar, nuk mora mundimin ta korrigoja.

— Vonohet shumë doktori, the?

— Ohu, nga darka do të kthehet. Nga Kallaja do të shkonte në Gështenjas, te një plakë e sëmurë.

— E po mirë, s'prish punë! Do vejë ku do vejë, prapë këtu do të kthehet!

U ngrit në këmbë:

— Dëgjo! Merri këto mollët, se më ka porositur yt atë. Ia kam zgjedhur kokërr më kokërr.

Në fillim doja ta kundërshtoja, po familjariteti që ai rrëfeu qysh në fillim ma kyçi gojën. Ndonëse unë nuk e njihja, ai duhej të qe mik i tim eti. Eh, etërit kanë një shije të çuditshme...

— Unë po dal pak tani, se kam ca punë. Mos u mërzit, hë! Kthehem shpejt.

Dhe doli e zbriti shkallët, kurse unë ngela te dera duke e ndjekur me sy. Dhe në gojë ndieja një shije të ligë, sikur brenda minutës, kisha thithur nikotinën e një pakete të tërë.

Në shtëpinë tonë hyjnë e dalin shumë njerëz. Kush për mall e kush për hall. Aq jemi mësuar ne me këto hyrjedalje, sa që, kur mbetemi vetëm në shtëpi, (dhe kjo ndodh rrallë), unë, babai, nëna, shohim njëri-tjetrin në sy dhe as buka na shijon, as na bëhet të shkëmbejmë dy fjalë.

Mahmuti kishte ardhur mu në çastin që unë po bëhesha gati të kyçja derën e të zbritja në plazh. Megjithatë nuk u mërzita për këtë. U mërzita qysh në çastin e parë, sepse ai po sillej



si të qe tatëzoti i shtëpisë. Hapi e mbylli dyert e dhomave, gjer edhe atë ku flinin prindërit, lavdëroi «qenefin allafrënga», u lidh në telefon me fshatin e vet dhe njoftoi «zbarkimin shëndoshë e mirë në jatakun e mikut më të ngushtë». Mysafiri është mysafir, dreqi e mori, duhet t'ia bësh të tëra nderet, po jo dhe t'i varësh në brez gelësat e shtëpisë!

Nejse, tani kishte ikur e do të kthehej prapë. Meqë babai nuk do të vinte për drekë, me nënën kishim thënë ta shtynim me ndonjë sallatë e nja dy vezë të fërguara. Po tani dreka duhej shtuar a la Mahmut. I telefonova nënës në punë, ajo mori leje, erdhi dhe nisi me ngut përgatitjet.

\*

\*

\*

Ora kishte kaluar nga katër e gjysma me neve po na këndonin zorrët nga uria. Mahmuti s'po dukej. Të mos e prisnim e të fillonim të hanim, ishte turp.

\*

\*

\*

Ai erdhi më shtatë e gjysmë. Dukej që atje tej se ishte çakërrqejf. I merreshin këmbët, i mba-

hej goja dhe pas çdo fjale i dilte duhma e alkoolit, a thua se, Mahmuti e kishte bërë gjumin e vapës brenda në kazan të rakisë.

— Isha te djali, — tha, — e kam oficer këtu...

Më kërkoi ujë.

— Na fal, — i thashë duke i dhënë gotën, — po na mbaroi uji që kishim në frigorifer.

— Eh, — psherëtiu, s'ke ç'i bën! Po dëgjo: na vër ca ujë të ftohet, ta kemi për pastaj; vër edhe rakinë brenda, se tani në verë ajo e uruar s'pihet e ngrohtë!

Zbathi këpucët dhe i vuri nën tryezë. Era e djersës më shpoi hundët. U ula t'i merrja.

— Jo, jo, — m'u hodh, — mos u lodh, s'prish ndonjë punë! Moj zonja e shtëpisë! — iu drejtua nënës. — Bjermë një duhan, se harrova të blija!

Ajo mori paketën time dhe ia zgjati. Ai mori një dhe e vuri në vesh.

— Dëgjo, — i tha, — në bufe ka cigare nga ato të frëngut. Nga ato bjermë, se kanë duhan të fortë e më kërrejnë mallin e fshatit! Aaaa Duhan burrash, jo llafe... More, sa kushtojnë këto?

— 12 lekë.

— O! Pse s'thua, badihava?!

— 12 lekë të rinj!

— Jaaaa! — ngeli për një çast gojëhapur, pastaj shtoi: — Hajt, se keni ju, keni!

Dhe e mbajti paketën nëpër duar e po luante me të.

\*

\*

\*

E kuptova përnjëherë se babai nuk e njihte fare mysafirin. Po Mahmutit aq i bënte. E rroku për qafe, e puthi katër herë pllajq-plluq dhe hyri përnjëherë në intimitet:

— Nga bredh ti, more? Miku ka tërë ditën që po të pret, kurse ti hiç!

Babai s'ia la fjalët t'i binin përtokë;

— Më falni, se s'po ju njoh... Jam dhe ca i lodhur....

— Jaaa! S'po më njihke, hë?! — ngriti sytë dhe gishtin ai, — Mahmuti, a i vvarë! Nga Xhërrica, që e bëmë rrugën bashkë nga Vlora në Lezhë, në tren, që s'kishe shkrepëse, që të ndeza cigaren... Hë, të bie ndër mend tani?

— Aha, po, po — ia futi kot babai.

Që të premtova për mollët... Hë? Që ta merrni vesh ju, i premtova t'i bija dy kile mollë dhe ia solla! Hë, — më drejtoi gishtin mua, hapi tërë pëllëmbën: — Pesë kile! Të zgjedhura një më një. I thera kaposhin shefit të planit që të më jepte pusullën, se kooperativa i ka me krëk ato pak mollë.

— Po ti sikur the që ke katër rrënjë mollë në shtëpi! — nuk m'u durua.

— Gabim! — vrenjti vetullat ai. — Thashë që do mbjell katër rrënjë. Dhe çdo vit, prodhimin e parë do ta hajë ky burrë këtu.

Dhe i ra me grusht gjoksit të babait.

Pas darkës Mahmutit iu tek që të kalonte edhe një herë në revistë tërë inventarin e shtëpisë, kësaj radhe në prani të prindërve. Inspektimin e nisi nga frigoriferi.

— Paçi shëndet t'i gëzoni! — uronte, duke e prekur çdo gjë me dorë. Mori një rrotë sallam:

— Ç'është kjo, more?!

— Sallam.

— Sallam?! Jaaaa! Sallam të pjekur kam ngrënë sa jam shqepur, po të ftohur në akull s'kam provuar. Kushedi sa i shijshëm do jetë... — dhe krap, ia nguli dhëmbët.

— Të bëftë mirë! — thashë, nga që u frika se mos e nuhati ç'bluaja ndër mend.

Përplasi gjuhën pas qiellzës, përplasi dhe derën e frigoriferit. Pesë shishe e birrës që kishin tepruar nga darka na lanë shëndenë bashkë me dy shishe kos.

— Mos u sëlëndisni, — na ngushëlloi, — qelqi i thyer sjell mbarësi.

Ngaqë i dridheshin duart prej pijes, i ra e u bë copë e çikë edhe një çajnik japonez, që prindërit e kishin me merak të madh. Babai shtrëngoi dhëmbët, i mblodhi duart grusht, pastaj tha:

— Një pas mesnate ora. Si thua, e prishim tani? Se jemi dhe për punë...

— Flini, ju, flini! Unë do të rri dhe një copë

herë me djalin. Para e kemi ditën mesër.

Ma kishte prurë shpirtin në majë të hundës. Më vinte ta mbërtheja për zverku e ta flakja përjashta. E vrava ca mendjen, pastaj dola në korridor dhe lirova njërën nga siguresat. Vetëm atëherë ai u shtri dhe filloi të gërhiste si kamion i paraluftës.

\*

\*

\*

Gjumi më doli vonë. Mahmuti rrinte në verandë dhe gjerbte më nge kafën.

— Më erdhi keq të të zgjoja, ndaj e zjeva vetë kafën, por e kam katranosur. Pa më bëj një tjetër ti!

Piu dhe kafën e dytë dhe, kur unë prisja të ikte, më tha:

— Dëgjo, është një pako gjalpë dhe ca sallam në frigorifer. Mos ma skuq me vaj luledielli vezën, se më bën dëm në mëlçi.

Meqë pas pak do të thyente qafën, ia bëra gjithë ç'më kërkoi pa u ndier. Madje i bëra dhe një kafe të tretë, sepse kafja u pilkej gjithmonë pas buke!

Më mori dhe cigaren e fundit nga paketa e «frëngut» dhe më urdhëroi;

— Ulu këtu tani!

U ula.

— Dëgjo, pashë një këmishë të mirë në dy-

qan, pa s'kam marrë shumë para me vete. Sikur ta bënim tani pazarin, hë? Mollët i bleva me 7 lekë, por, meqë jemi miq, do t'ju marr vetëm nga pesë. Nuk i dua dhjetë lekët, zëre se pimë një kafe bashkë.

U habita, më iku zëri, nuk e prisja një gjë të tillë. Megjithatë u çova të merrja paratë. Befas, një shejtan i vockël më thirri nga brenda vetes dhe më tha diçka.

— Do të t'i jap, — i thashë Mahmutit, — por më parë do të bëjmë një llogari bashkë!

Mora laps e letër e nisa të shkruaja:

8 dopio raki, nga 3 lekë .....	24	lekë
4 kafe, nga 2 lekë .....	8	>
5 birra, nga 2 lekë .....	10	>
2 shishe kos, nga 2,7 lekë .....	5,4	>
1 paketë «Dunhill» .....	12	>
1 çajnik porcelani .....	300	>
Shuma .....	359,4	lekë

— Darkën dhe fjetjen nuk po t'i vë në llogari, — i thashë. — Mbaj dhe 35 lekët e mollëve dhe më lër këtu 324,4 lekë, ndryshe thirra policinë!

E nuhati se s'po bëja shaka. U zverdh, u gëlltit:

— Dale, a i vrrarë! — buzëqeshi, — Një shaka bëra. S'hake fare pykë ti?! Të kam dhe djalin e milkut!

— Mikzeza! — i shfryva. — Miq si puna

jote mos ia zënçin kujt derën, as për mirë, as për keq!

Iu mbush mendja top se me mua nuk i mprhihte dot qetë. As «njatjeta» nuk tha, po zbriti shkallët dhe iku.

# KRONIKË E NJË JETE TË PAJETUAR

novelë

Gjyshe Malia, nënëmadhja e tërë mëhallës, mbaroi së bluari kafën dhe u shkryth. Gishtat kërcitën butë dhe ajo ndjeu një lehtësim të menjëhershëm, që iu përhap në gjithë trupin. Nuk e mbante mend sa vjeçe ishte, po mendjen e kishte top. Askush, as prindërit, as vëllezërit, nuk i kishin thënë se kur kishte lindur, po ç'rëndësi kishte? Mos vallë kjo e kishte penguar plakën që shtatëdhjetë e kusur vjet të çapitej nëpër mote e të shpërndante kudo mirësi pa kursim?

Ai mëngjes i bardhë llastohej si djalë i vetëm dhe gjyshja befas e ndjeu veten të rinuar. Deti ia prehte sytë me atë ngjyrën e bekuar të gurkalit, ajri i pastër i hynte në mushkëri, trazuar me kundërmimin e mushtit që valonte në fuçitë; nja dy dallëndyshe ecejaknin nëpër verandën e shtëpisë, sikur u vinte keq të iknin e të merrnin udhët e mërgimit.

— Bukuri! — foli me vete plaka dhe pastaj



hodhi në xhezve tri lugë kafe e një sheqer dhe zbriti shkallët. Eci mes kaçubeve të dafinave dhe hyri në oborrin e fqinjit, Panush Dhimës, për të pirë, ashtu si njëzet vjet me radhë, kafën e mëngjesit.

Pulat në kotec kakarisën dhe plaka buzëqeshi. «I ka harruar mbyllur, derëziu!» Hapi derickën dhe pulat vërshuan me shamatë të madhe nëpër oborr. Fli, o i uruar, fli! — foli me vete plaka dhe për të njëmijtën herë ndjeu keqardhje për Panushin, i cili e kishte shtyrë si eremit jetën e vet.

Pjergulla kishte nisur t'i hidhte gjethet. Ato shkëputeshin nga degët duke bërë një «krak» të butë dhe me një zhurmëz fëshfëritëse zinin vend në plloçat e verdhëreme të avllisë.

I thirri dy-tri herë ngadalë, po Panushi ose tallej me plakën, ose ende flinte, ose... Jo, kjo s'kishte mundësi! Po të largohej ai nga shtëpia, Malia do ta dinte patjetër. Kështu, pra, ai ende po flinte. Nga ky mendim plaka buzëqeshi përsëri.

Panushi po flinte vërtet, po ky ishte një gjumë tjetërsoj. Me sytë të hapur si kamare, me kokën të varur mënjanë e dorën thatime lëshuar pa fuqi mbi qilimin e ngrënë nga mola e vitet...

Llumi i kafes, që vishte anën e brendshme të filxhanit ngjante me një hartë të zgërlaqur nga lagështirat, dherat e shekujt. Panushi rrinte në karrige si një bishë grabitqare në përgjim, gati për t'iu vërsulur presë së vet. Arixhofka, pasi e ktheu filxhanin mbarë e mbrapsht, duke lllomotitur ca tinguj të pakuptueshëm, nisi më në fund t'i fliste:

— Një mërzi të madhe ke, mësje!... Qeveria ta ka ulur kokën. Po do rregullohesh, vetëm se me pak vonesë. Ja, mësje, shihe vetë! Kafen e ke pirë këndeje, po pasqyra e gëzimit të del në anën tjetër, ja, e sheh?... Pupu, mësje! Ç'kryq i bukur! Ç'vajzë nure po të pret! Ja, si një zog i uritur po të pret, mësje! Me këngë... Kësmetin e ke të madh, mësje, por jo këtu, në vendin tënd, mësje. Barku yt është në merak për ty.

— A vonon shumë kësmeti? — pyeti më në fund ai.

— Oooh! Vonon, mësje, shumë vonon. Por jo këtu, në vendin tënd, mësje!

I la arixhofkës ç'para kish në xhep dhe doli duke tërhequr këmbët zvarrë.

Kishte tre muaj pa punë, domethënë pa personalitet. Kur punonte në zyrën e vjeljes së taksave, kishte një tryezë e një karrige, kishte një garsonierë e një krevat, kishte ca pak para

mënjatë dhe shumë miq përreth. Miqtë e tij më të ngushtë e më të mirë qenë kolegët, katër shokët e zyrës. Me ata pinte kafën e mëngjesit, me ata diskutonte për përgatitjet e Kampionatit të Tretë Botëror të futbollit e për filmat e Greta Garbos (e cila sapo kishte mbushur 32 vjeç), me ata hante drekë dhe kalonte pjesën më të madhe të kohës. Në fakt, nga tërë nëpunësit, vetëm ai ishte beqar, 25 vjeç djalë. Dhe kolegët i joshte shoqërimi i tij gjatë kohës që Panushi hante drekë në restorant, sepse shishen e birrës dhe mezen modeste ua paguante gjithmonë ai, ai që kishte vetëm kokën dhe rrogën, kurse kolegët kishin gra, kishin fëmijë, kishin ato lloj detyrimesh të denja vetëm për kryefamiljarët.

Qyteti ishte i vogël, një nga ato qytetet e Afrikës së Veriut, që sapo kishin nisur të civilizoheshin, por që ligjet e parasë i njihnin fare mirë, pa qenë nevoja t'ua mësonin ata, nëpunësit e shtetit gjysh, që e kishte marrë shtetin e njomë nën sjetull. Në ata dy vjet, dy muaj e dymbëdhjetë ditë të shërbimit në zyrën e vjeljes së taksave ai, dashur pa dashur, ishte ngjitur në elitën e qytetit. Sidomos tregtarët e vegjël e nderonin me një servilizëm të hapur. Po, pas gotës së tretë të verës, tërë ata bakallë që i mblidheshin rreth tryezës dhe e gostitnin, i ngjanin Panushit si vëllezër me nënë tjetër.

Belanë e gjeti nga Hafëz Salepi, njëri prej gjashtë perimeshitësve të qytetit. Ia bëri zemrën copë duke i thënë se kjo djall thatësire e paparë po e çonte drejt falimentimit të sigurt dhe se pagimi përnjëherë i gjithë shumës së haraçit do t'ia vdiste për bukë të trembëdhjetë fëmijët. (Kur Panushi mori vesh se Hafëzi martohet përnatë në bordelin e qytetit, qe vonë). Kështu që ai u prek dhe, pasi e shoshiti mbarë e mbrapsht, vendosi t'i merrte vetëm gjysmat, kurse pjesën tjetër Hafëzi ta shlyente me këste. Kjo ndodhi të nesërmen e tregimit të filxhanit nga arixhofka Semiha, — që ai e bënte çdo të enjte (Një qen i madh e i zi të qëndron në mes të rrugës. Ruaju!) — dhe një ditë para se të vinte për kontroll inspektori i përgjithshëm i Ministrisë së Financave të shtetit gjysh. Për inspektorin, tërë nëpunësit që vareshin nga Ministria e Financave qenë vetëm shifra. Dhe një nga këto shifra, domethënë Panush Dhimën, ai s'e kishte hiç vështirë ta shumëzonte me zero...

Pasi la cigaren dhe kafën, ai filloi të hante vetëm një herë në ditë bukë të zezë dhe ullinj. Erdhi dita që kursimet iu sosën dhe atij i mbetën në xhep aq të holla, sa, po ta vidhte ndokush, të mos e shante: «Paloburrë, pa një dyshkë në xhep!».

Shokët e dikurshëm të zyrës e kishin prerë

pijen e drekës, madje ata kishin prerë dhe përshëndetjet e zakonshme që i bënin Panushit. Një njeri që ishte shtëmëngur nga shtrunga e ligjit, s'mund të qe i denjë për ta, pa le t'i kishte qerasur jo dy vjet, po makar 20!

Ecte rrugëve të përzhitura të qytetit, vetmi-tar e i kërrusur. Miqtë e dikurshëm i shman-geshin si të qe lebroz. Nga qielli i elitës ai kishte përfunduar në llum.

Një grusht sallatë jeshile dhe një copë bu-kë bajate i kërkoi Hafëz Salepit. Qenë mbushur pesë ditë që Panushi s'kishte vajtur në nevojto-re, për arsyen e thjeshtë, se nuk kishte shkakun që duhet të ketë çdo rob i perëndisë për të shkuar atje.

— Më vjen keq! — hapi krahët Hafëzi. — Ç'të të bëj unë i mjeri?! Nga njëra anë haraçet, nga tjetra kalamanët, ja, më thuaj, ç'mund të të bëj?!... Po dëgjo, duku pas nja tri ditësh. Mba-se gjej ndonjë fije sallatë për ty!

### 3.

Ndryshe nga krahët dhe këmbët, truri puno-ka më shumë e më mirë atëherë kur zorrët këndojnë marshin e urisë. Atëherë, i ziu njeri sheh ëndrrat më të bukura, thur planet më optimiste, bën punën më të mençur. Domethënë s'bën asgjë.

Qyteti kishte shumë kazanë plehrash. Netve,

pasi banorëve ua mbyllte sytë për gjumë allahu, Panushi dilte si lugati dhe rrëmonte kazan më kazan. I gjente ca kore buke, gjente edhe ca lakra a patate gjysmë të kalbura dhe, kur kthehej në garsonierën e tij, qiranë e së cilës, lavdi zotit, e kishte parapaguar për tre vjet, u fuste një të zier dhe bënte një supë që të lëpije gishtat. Nuk thonë kot për rrufenë: i ra lisit, e përvëloi; i ra malit, e shkretoi; i ra njeriut, e duroi.

Në këtë jetën mizerabël të fukarait, ai kishte vetëm një gëzim, më saktë ngushëllim: Edit Piafin. Ajo ishte këngëtarja e tij, idoli i Panush Dhimës, Krishti dhe Muhameti i tij. Pllakat e saj i kishte blerë të tëra dhe për këtë u kënohej dikur kolegëve të vet. Po gramofoni? Ai ishte mrekullia e tetë e botës. Nga ata që kurdiseshin me një manivel të vockël. Në vaktin e artë të tij Panushi e merrte me vete bregut të detit, apo tej nga kodrat dhe për të shtatëqindmijtën herë përsëriste me zë të lartë fjalët që do t'i thoshte Piafit, kur të vinte çasti fatlum i njohjes me të. Ky çast do të vinte patjetër. Jo më kot arixhofka i pati thënë në filxhan se zogu i uritur e priste me këngë.

Po tani le të zbriste në tokë të kthehej te realiteti i dhimbshëm, te dita që po gdhihej. Gju-mi ishte e vetmja mundësi, tani për tani, që të takohej me Edit Piafin. Në këtë botë, jo në botën tjetër. Se në atë botë këngëtarja mund të shkonte shumë më vonë nga Panushi dhe atëherë

kish të ngjarë të mos i binte ndër mend djalo-  
shi i mjerë, i cili në ëndërr qe martuar kaq  
herë me të.

Dhe, meqë kishte shkuar goxha vonë, ai nuk  
bënte keq të martohej me Piafin edhe këtë  
natë...

4

E nesërmja u gdhi shpejt dhe ai brofi nga  
shtrojat i freskët e i sigurt. I tendosi dy-tri  
herë fort këmbët e pantallonave për t'u shtruar  
rrudhat, mbështolli diçka me një çarçaf, për-  
plasi me gaz derën pas vetes dhe doli në rru-  
gë duke fërshëllyer.

Zhilber Luisë i pati bërë gjithë ato ndere.  
Ky dukej burrë i mirë dhe Panushi e kishte  
ruajtur si gur të fundit; nuk e kishte bezdisur  
asnjëherë gjatë tërë atyre muajve të kiametit.

Ecte dhe një ndjenjë e veçantë, por e vë-  
shtirë për t'u përkufizuar, e bënte euforik. I  
gëzuar ishte, gjithsesi. I ngjante se me ata xhe-  
pat e tij bosh e të ngrënë nga fërkimi i pafryt-  
shëm i gishtave mund të blinte gjithë botën,  
ose, të paktën, vetëm atë qytet të pluhurosur, si  
bajgë e thatë, që ligjet e parasë i njihte aq mi-  
rë.

Sonte Editi kishte qarë. Ndoshta nga lum-  
turia. Patjetër nga lumturia. Gjithsesi, ky ishte  
një ogur i mirë. Pastaj, kishin kaluar aq muaj

qyshse arixhofka i kishte treguar pasqyrat e gëzimit.

Zhilber Luija nuk ishte më tepër se 38 vjeç, po mirësia që rrezatonte, e bënte të ngjante si babagjysh.

— Ah, biri im, — psherëtiu ai, — ti u dhimbesh edhe gurëve! Pse të të ndodhë ty kështu? Pak vemje kishte zyra juaj?

Panushi buzëqeshi, pastaj psherëtiu dhe ai.

— Po mirë, — vazhdoi Zhilberi, duke vënë mbi banak një gotë verë dhe një copë kek, — si s'ke ardhur tek unë? Apo mos pret të vij unë e të të lutem? Kam një vend bosh. Paga vërtet nuk është kushedi se çfarë, po ma ha mendja se tërë këtë kohë e ke bërë kurën e skamjes; para fukarallëkut tënd, rroga që do marrësh tek unë është lule. Hajt, me krahë të lehtë!

Panushi e ngriti gotën, por, pa e vënë te buzët, e la prapë mbi banak:

— Falemnderit, zoti Lui, por... unë do iki që këtej. S'bëkam dot prokopi këtu, do të kthehem në vendin tim.

Zhilberi u step, pastaj, duke e parë drejt në sy, tha:

— Unë këtu mundësi kam. Hëpërhë nuk je keq, vetëm do të regjistrosch ç'mallra hyjnë në dyqan. Kjo është e gjithë puna jote.

— Jo, e kam vendosur.. Kam sjellë këtë gramafonin për të shitur. Është markë e mirë,



vetëm dy vjet i përdorur. Kam dhe tërë disqet e Edit Piafit.

— S'është nevoja t'i bësh reklamë, unë e di vetë. Po mendohu dhe një herë!

— Jo, jo! Kësmetin e kam gjetkë!

— Biri im, kësmeti është si zogu. Rri majë pemës, në qejf të vet. Ti i afrohesh për ta mbërthyer, mirëpo, sa zgjat dorën, ai të lëshon një glasë e fluturon gjetiu.

— Vërtet, po zogu im nuk fluturon, ai më pret. S'ka zot që ma kthen mendjen për këtë!

Dhe, për ta bërë shitjen fakt të kryer, siktoi:

— Më duhet të rri nja dy javë në Paris, pastaj do të nisem për në atdheun tim.

Duke dalë nga dyqani, dëgjoi zërin e Zhiberit:

— Një zog që s'fluturon, është zog i plago-

sur!...

## 5

Nga gëzimi kishte harruar dhe çarçafin, po s'e çante kokën për të. Qysh nesër do t'i hipte së parës anije dhe drejt e në Paris! Paret i rëndonin në xhep. Ai e ndiente veten burrë 100--e ca kilësh; kishte rifituar personalitetin.

Për herë të parë pas kaq kohësh hëngri tri gjellë, piu dhe dy gota birra. Pastaj shkoi në dhomë, bëri një kafe të rëndë, ndezi një cigare dhe, pasi e gjerbi me nge lëngun e zi,

duke soditur qytetin që gogësinde nën zagushinë, e përmbysi filxhanin.

Herët e tjerë nuk e kishte veneruar me kujdes arixhofkën. Ajo, megjithëse e shkuar në moshë, — eh, jo dhe e shkuar, i kishte a s'i kishte 40 vjeç, — ruante gjurmët e një bukurie të hershme joshëse. Buzët e trasha e plot lëng, sytë dinakë, në të cilët lëvrinte një dritë e tjetërllajtë, gjoksi i madh e i lëshuar dhe, veç këtyre, aroma e këndshme e trupit lozonjar, tregonin se Semihaja e dinte ç'është jeta.

— Pupupu, mësje! — përplasi pëllëmbën pas kofshës së bëshme. — Filxhan kaq të bukur rrallë kam parë! Një rrugë e gjatë të pret, diku shkëputet, po shkëputet për mbarë; ja, e sheh lulen këtu? Mbarë e më mbarë të shkon rruga, mësje! Vetëm të mira ke! Pupupu, pare, këngë.. Një vajzë, një yll thua j më mirë, veç për ty mendon, ja, ka ulur kokën dhe po të pret t'i kthesh gëzimin...

Po Panushi nuk dëgjonte më. E bukur dhe joshëse që arixhofka, njëllëj edhe filxhani, por Edit Piafi ishte ku e ku! Ajo që Afërdita që zoti ia kish dhuruar Panush Dhimës bash këtë mbrëmje prilli. Dhe, duke përkëdhelur trupin e Edit Piafit, Panushi e ndiente veten perëndi të 13-të të Olimpikut.

Thanas Zheroja i mbajti rremat kundra përdisa çaste dhe varka, si mushkë e shtruar, u ndal një pëllëmbë larg shkëmbit. Thanasi, nja 35 vjeç burrë, që natyra ia kish falur çdo gjë pa kursim, trupin kaba, hundën e madhe që ngjante se ia kërreste kokën përpara, si dhe veshët gjithashtu të mëdhenj, kërceu si depur dhe e lidhi cimën pas shtyllës që qe ngulur si pykë në një të çarë të shkëmbit. Pastaj i mori valixhet Panushit dhe i dha dorën që ta ndihmonte të hidhej.

— Ja ku e ke fshatin, — i tha, — s'ka lëvizur asnjë santim. Që kur ke ikur ti, vetëm një shtyllë është ngulur, dhe tregoi me dorë aty ku qe lidhur cima, — e ngulën unë kur bleva varkën.

— Rrofsh, Thanas! Hajde të pimë një gotë!

— Do ta pimë gotën, por në shtëpinë time, — i tha Thanasi, — ti akoma je jabanxhi këtu e në kafene do na bezdisin mëloti. Ke kohë të piqesh me ta e t'u tregosh habëret e Afrikës, se ato të Parisit e Romës ua sjell unë javë për javë.

S'kishte ndonjë qejf të madh të rrinte me Thanasin, i cili, me sa dukej, donte t'i bente edhe një herë më nge tërë muhabetet e rrugës, ndonëse vitet që e ndanin s'qenë ndonjë di-

ferencë kushedi se çfarë. Donte të shkonte sa më parë në shtëpinë e vet, të përgatiste pusinë e kësmetit e pastaj të shtrihej e të mblidhte kokallat. Megjithatë, për mirësjellje, iu bind Thanasit.

2 Kur iu afrua shtëpisë, indjeu një sëmbina në zemër. Ajo heshtte e strishtuar, si i sëmuri pa shpresë shërimi. Kanatet e dritareve dhe porta — e kaq vjetër të mbyllura, — gjembaçët sa një bojë njeriut, ca tjegulla të thyera për tokë, iu bënë se ranë të gjitha përmbi të duket e mallkuar.

I ati e kishte lënë 14 vjeç dhe kishte marrë udhët e kurbeteve. Dy vitet e para u dërgonte shpesh para, ngandonjëherë edhe letër USA, Australia, Turkiy, Belgique. Dhe pastaj Heshtja. Në dy vjet i kishte rënë botës kryq e tërthor, a' thua se parandientë apokalipsin. Me punë zihet mirë, i se kishte marrë diplomë në një shkollë politeknike të Francës.

Pas heshtjes së të atit, vdiq e ëma, dhe Panushi, pa ç'pa, një ditë prej ditësh futi në kuletë gjithë ç'para kishte shtëpia, (dhe s'qenë pak), theu një shishe raki te pragu dhe i hipi benzinatës që bënte rrugën Porto Palermo — Korfuz e kthim.

Gati tre muaj e jetoi jetën, sa i nxori ujë të zi. Athinë, Pire, Brindisi, Romë, Milano, Paris,

Marsejë, Tripoli. Gjersa në një gazetë lexoi lajmërimin ku thuhej se Ministria e Financave kërkonte një nëpunës 20-25 vjeç, të përgatitur në gjuhë e matematikë. Mes 179 rivalëve, fati i buzëqeshi Panush Dhimës, i cili kishte kryer Liceun e Korçës.

Menteshat e poftës kërcitën si eshtrat e një njeriu që kishte lënguar gjatë në shtrat. Era e mykut i zuri frymën, një pezhishkë iu përplas në fytyrë dhe ai, instinktivisht, nisi të ecte gjysmë i përkulur.

A thua kësmeti i tij ishte kjo katrahurë prej gurësh e dërrasash, e plakur para kohe?

Gjithë natën nuk qvuri gjumë në sy. Valët monotone të detit e bëzdisnin, si tingujt e një disku, të cilin e gërvisht gjilpëra e thyer. Sapo bëri këtë krahasim, mendja i shkoi përsëri tek Edit Piafi. Për të mbushur sadopak atë vakuum të errët përreth tij, nisi të fliste me zë të lartë:

— Edit Piaf. Edit Zhanë Gasion. La vie en rose!

Pastaj nisi të këndonte nën zë meloditë e saj. Pastaj rrsi kokën nën jastëk dhe fluturoi në Paris...

Paratë që i kishte dhënë Zhillberi për gramafonin, jo vetëm i mjaftonin, por, po të tregohej pak ekonomiqar, do t'i dilnin edhe për ta filluar normalisht jetën në vendlindje.

Sapo Piafi përshëndeti për herë të fundit atë natë klientët e kabaresë «Germy's», Panushi rendi si lepur nëpër anekset e lokalit dhe e mbajti frymën para nderës ku shkruhej «Mademoiselle Piaf». Rregulloi kravatën, hoqi një qime nga xhaketa, u shkoi një dorë flokëve, pa dhe një herë buqetën e madhe me lule dhe trokiti.

— Hyr! — u dëgjua nga brenda zëri i magjishëm.

O zot i madh! Vërtet, ajo ishte. I kishte kthyer kurrizin, po s'prishte punë. Supet i kishte të zhveshura, zinxhirin e fustanit të ulur gjer në mes. Në pasqyrën luksoze Panushi shihte fytyrën e saj engjellore.

Sa kohë kishte vallë që po shihte këtë mrekulli, këtë ëndërr?

Këngëtarja, me sa duket, e vuri re, sepse u kthye paksë nga dera dhe tha:

— Uluni!

Njëri gjoks i bukur, i vogël vërtet, po gjithsesi i bukur, krekosej si kokë meduze para tij. Dhe airtimthi i vockël — i vockël sikur ngulej drejt e në zemër të Panushit.

Piafi vazhdonte të krihej, pa e pasur mendjen tek ai. Qofsh e bekuar, mojt arixhofka Semihah! Tis'qenke njëri, po perëndi!

Në atë çast dera u hap papritur e me vrull dhe një djalosh i pispillosur vërshoi brenda duke llometitur me zë të lartë. Panushi u ngrit ta ndalonte, po pispilluqi nuk ia varri fare. U përkul mbi zverkurë Piafit dhe nisi t'ingucuriste në

vesh. Pastaj u çuan të dy në krahët e njëri-tjetrit dhe këngëtarja i tha Panushit:

— Falemnderit për lulet, mund të shkoni!

Eh, vetë e pati fajin! Arixhofka i kishte thënë vërtet se Piafi e priste krahëhapur, po kjo s'nënkuptonte që Panush hajvani të rrinte duarkryq. Ç'priste ai? Që sapo të shkelte në derë, Piafi të brofte nga karrigia e t'i binte të fikët në krahët e tij? Duhej t'i fliste, t'i afrohej, t'i hapte zemrën. S'qe as i pari as i fundit mashkull që i shkante këngëtares për t'i shprehur adhurin e vet.

4

Mëngjesi erdhi më shpejt nga ç'e priste. Erdhi si një i dehur që përmbys gjithçka e të bezdis sa s'thuhet. Shtëpia i ngjante sarajit të satanait. Merimangat kishin ngritur kudo perandorinë e tyre: nëpër qoshet e mureve, në këmbët e mobiljeve. Edhe mbi velenxën me të cilën qe mbuluar Panushi shtrihej si dantellë një pezhishkë e dendur dhe e madhe.

U ngrit dhe doli jashtë. Dielli ia vrau sytë. Ishte një diell i ndritshëm e i bukur, jo si ai dielli që vinte era kalbësirë i Afrikës, apo dielli mediokër i Parisit. Dallëndyshet po cicërinin mbi degët e pjergullës dhe ai mendoi se, sigurisht, ndonjëri prej atyre dallëndysheve e kishte parë edhe atje, në atë qytetin e pluhurosur të Afrikës, Veriore.

— Ç'bëhet tani atje? — foli me vete dhe solli ndër mend tërë peripecitë e atyre tri viteve larg atdheut. Edhe një ditë të vetme ta kish jetuar atë jetë, ai do të mund ta riprodhonte atë ditë gjersa të vdiste, kaq të shumta do t'i kishte kujtimet prej andej, sekondë e kujtim.

Këtu i duhej ta niste jetën nga e para. Vresh-tat ose do t'i shiste, ose do t'i jepte me qira. Në nënprefekturë do të gjendej ndonjë vend pune edhe për të. Fjalët e arixhofkës e kishin mbu-shur me shpresë. Shpresa është gjë e madhe. Kur vdes ajo, vdes dhe njeriu. Shpresa e tij s'rrinte në hava. A s'ishte zëri i arixhofkës zëri i qiellit? Ç'i kishte treguar filxhani dhe nuk i kishte dalë? Të gjitha, pa përjashtim. Tani, ras-ti me Edit Piafin ishte vërtet një përjashtim. Po Panushi e kishte shkëlmuar vetë fatin. Sepse fatin ta shkruan zoti, ta shkruan, dhe ti s'ke si i shkon kundër. Në rastin e Edit Piafit ai kishte bërë një sakrilegj të madh, të pafalshëm. Mos ngri krye kundër fatit, njeri! Zoti është i madh e të fal, ama, kur ia sjell në majë të hundës, të vjen hakut e të kthen në një mjeran të po-cëqisur!

5

Dielli qe ngritur goxha kur erdhi Jani Pa-noja. Qenë rritur bashkë, ngjitur shtëpitë. U pu-thën e u përqaftuan, ndenjën gjatë në krahët e njëri-tjetrit dhe atëherë Panushi e kuptoi se e



paskësh marrë malli i madh për vendlindjen. Jo vetëm për njerëzit, por edhe për gurët, për detin, për atë përrallin e vetmuar prapa shtëpisë, ku ai kishte çjerrë bërrylat e gjunjët dhjetëra herë, kur luanin me kalamanët e mëhallës.

— Hajde të dalim, — po i thoshte Jani, — shtëpinë do të ta pastrojë Malia nusja ime. Jam martuar, pres të bëhem baba. Dalim njëherë, pastaj je për drekë nga unë!

Nuk i tha as po, as jo, nuk i foli asnjë fjalë. Vetëm buzëqeshi.

Në qendër të fshatit kishte gjallëri. Të tria kafenetë qenë plot. Ishte fund maji dhe njerëzia e nisnin punën që pa gdhirë në ara dhe e linin shpejt. Jorgji Kallogrica, nja 5-6 vjet më i madh se Panushi, po tundte para klientëve të vet një rufio 15-kilësh, që sapo e kishte zënë me parangall. Sekretari i nënprefekturës, një gjirokastrit, po u lexonte kureshtarëve himnin e ri të shoqërisë sportive. Një i dërguar i princeshës Myzejen po pyeste për notarët që do të merrnin pjesë në kampionatin kombëtar, në Durrës.

Ky ishte një fshat i çuditshëm. I kishte as'i kishte një mijë banorë, sepse shumë e shumë braniseshin udhëve të botës. Këngëtarët e shoqërisë kulturore patën tronditur Parisin disa vjet më parë, kur kishin shkuar për të incizuar në disqe këngët e tyre. Atletët e fshatit qenë kampionë të vendit dhe kishin marrë pjesë edhe në Ballkaniadën e Zagrebit më 1934.

Nga kurbetçinjtë, më tepër humbiste qeveria, e cila asnjëherë nuk siguronte numrin optimal të votuesve. Kurse fshati, po të lije mënjanë mallin gërryes për të dashurit e zemrës, fitonte civilizimin, etjen për të cilin, tradicionalisht, e kishte në shpirt.

### III

1.

Lufta erdhi shumë shpejt dhe po aq shpejt edhe iku për Panushin, që s'u ngatërrua me kërrkënd. Ata pesë vjet i shtyu duke fërshëllyer këngët e Piafit dhe me psikozën donkishoteske të optimistit. Lufta ishte diçka e predestinuar për të ndodhur dhe në fund të fundit ishte më pak e rrezikshme se një epidemi murtaje. Për Panushin lufta ishte dhimbja e virgjëreshës, e cila do t'i pille atij kështetën. Dhe për ta hequr mendjen nga dhimbjet e tmerrshme — siç kishte dëgjuar — të lindjes, ai kujtonte çastet që s'i kishte jetuar kurrë me Piafin. Një dashuri tejet romantike, që mbartte në vetvetë diçka shekspiriane. Shëtitjet e këndshme në rrugët e Parisit e buzë detit në Marsejë, netët e mbùshura me një erotikë të përsosur, mbremje të tejngopurë nga malli e çmallimi, aty, te lozha e rezervuar enkas për Panushin, sa herë që Piafi jepte koncerte dhe ai e priste të mbaronte, që të gjendeshin sërish bashkë, mbi çarçafët e dallgëzuar,

dhënë në krahët e epshit, mirëkuptimit e misterit.

Në fillim ai e ndiente se ç'tmerr ishte ta mbaje veten me kujtime ngjarjesh të pandodhura; qe njëlloj si të ngopeshe me lugë të zbrazët. Mirëpo dalëngadalë iu mbush mendja top se në gjithë këto kujtime s'kishte asgjë të trilluar, madje habitej se si dikur e pati vënë në diskutim vërtetësinë e tyre.

Po të qe treguar më pak i mençur, mund të kishte bërë prokopi. Po jetën e vet e kishte vënë brenda një kornize të ngushtë: Edit Piaf, përmbysje dhe lexim filxhani, shitje të vajit dhe të rakisë. Vreshtat dhe ullinjtë që i patën lënë prindërit, qenë sikur i kish bekuar perëndia, të mbara dhe që s'kërkonin shumë shërbime, përjashto ndonjë punim a ujitje, që Panushi ua bënte sa për të shkuar kohën.

Disa herë komshinjtë e tij, që u dhimbe në zemër për të, i kishin bërë propozime për martesë, me vajza të bukura, punëtore e nga dyer të sojme. Po ai ngulte këmbë si mushka e s'tundej nga vendimi i tij. Gjersa, avash-avash, të gjithë nisën t'ia hiqnin fillin. Boll kishin telashet e tyre, do merreshin dhe me një të luajtur tani?

2

Si zakonisht, edhe atë mëngjes e piu kafen pasi u la e u rrua. Si zakonisht, e përmbysi filxhanin dhe pas gjysmë ore e mori në majë të

gishtave. Si zakonisht, në fund ishte mbledhur llumi i zi, shenjë e mërzisë së përhershme, me disa rrëkeza bosh nëpër të. Këto e tregonin qartë se, edhe mes atij llumi, prapëseprapë, kështu luftonte të dilte mbi ujë. Gati ngjitur me vendin nga e kishte vënë filxhanin në buzë, shqoi një zog krahëhapur dhe zemra i fërgëlloi. Zog i vogël, vërtet, por që gjithësesi tregonte për mbërritjen së shpejti të një haberi. Ç'mund të qe vallë ky habër? Dhe nga mund të vinte? Nëpër tru i vetëtiu për një çast emri i Edit Piafit. Ku ta dish? Ndoshta zoti i kishte dëgjuar lutjet e Panush Dhimës dhe, kur pati ardhur vakti i duhur, e kishte vënë dorën në zemër...

Dhe haberi mbërriti. Po s'erdhi në formën e një letre apo të një dallëndysheje farfuritëse. Haberi u avit me një trokitje të rëndë dhe, kur Panushi hapi portën, dy partizanë, veshur me kapota të murrme e me fytyra gjithashtu të murrëtyera, e nderuan me grusht:

— Vdekje fashizmit!

— Urdhëroni! — ia bëri Panushi me dorën e majtë, se në të djathtën mbante filxhanin.

— Hëm! — u ngrys më tepër njëri nga ata, më i moshuari. — Kjo është shtëpia e Panush Dhimës?

— Po, unë jam.

— Aha, qenke ti! Do të vish me në në komandën e vendit!

— Po përse?! Unë s'kam bërë gjë! S'jam trazuar me njeri!

— Eh, borgjez i djallit! — nënqeshi tjetri, që sapo i kish dërsirë qimja në faqe. — Mos ki frikë, jo! Do vish me ne se të do komisari. Nuk të vrasim, de!

Veshi pallton dhe doli pas tyre. Duke zbritur monopatin të gurtë, i futur mes dy partizanëve, iu bë se i tërë fshati i kishte qepur sytë mbi të. E çoi mendjen te Piafi.

Zyra e komisarit ishte në ndërtesën e ish-nënprefekturës. E varfër, si vetë pronari i ri i saj: pa asnjë mobilim, me përjashtim të tryezës së rëndë e telefonit me kabëll të këputur, dy karrigeve... në mur që varur një hartë fizike e Azisë, që një djall e dinte se për çfarë ndodhej aty!

Pritja që i bëri komisarit, e ngrohu. Ai kishte pothuaj moshën e Panushit dhe ky veneroi se fytyrës së tij engjëllore nuk i përshtatej fare gjerdani me fishekë dhe automatiku i zi e i rëndë, që dremiste mbi tryezë. Me komisarin dolën dhe të njohur. Ai kishte punuar dy vjet në Sent-Etien, në minierë, bashkë me dy kushërinj të Panushit dhe kishte fjetur në një krevat me ta.

— Ne sapo kemi dalë nga lufta, — foli komisarit, — bile në çerekun e atdheut akoma luftohet. Megjithatë jemi shtet i ri dhe, edhe në luftë, tërë mekanizmat e shtetit duhet të funk-

sionojnë, apo jo? Na duhet një llogaritar i aftë për komisionin e tatimeve, që sapo u krijua, e më mirë nga ti s'ka kush e bën këtë punë. Do të kesh edhe rrögën tënde, kuptohet, brenda mundësive tona, po nga hiçja, mirë edhe Birçja, apo jo?

— Kuptoj, — tha pasi u mendua pak Panushi, — por ...

— E marr më mend, — e ndërpreu komisarri, — po për ne s'ka rëndësi ke qenë a s'ke qenë me Lëvizjen. Ne s'jemi si Hitleri. Hitleri kishte parimin «Kush s'është me mua, është kundër meje». Neve s'na intereson e shkuara jote. Sepse, — i mëshoi zërit, — ti nuk ke patur të shkuar. Të paktën këto vitet e luftës. Ne duam që t'i vësh të gjitha forcat për t'i shërbyer pushtetit popullor. — Përsëri i mëshoi zërit: — Duhet t'i shërbesh këtij pushteti! Dhe atëherë ke për ta kuptuar domethënien e jetës.

— Dakörd! — tha Panushi, i bindur se ky qe fati i tij dhe ndaj fatit s'kish si ngrinte krye.

3

Puna s'ishte dhe aq e keqe. Madje ishte ku e-ku më atë rutinën mediokre të vjelësit të taksave në atë qytet të shtetthit të njomë, që shteti gjysh e kishte marrë nën sqetull, për ta mbrojtur e mëkëmbur. Vërtet, nënprefektura s'kishte dhe

aq të kamur, në mënyrë që robi, duke u vënë tatimet atyre, të mendonte se po kryente mrëku-llinë e tetë të botës. Por gjithsesi, duke parë ata pasanikë që gjer dje nuk begenisnin t'i hidhnin as qurrat, tek e përçmonin «Ih, i lajthituri!», ai e ndiente sedrën t'i kënaqej e t'i bëhej mal. Tregtarët, (ish-tregtarët, se tani i patën hedhur nga fiku), e vështronin me ca sy qaramanë, lутës, që dukej ashiqare se lypnin mëshirë. Por ai s'ua falte këtë komoditet, komoditetin e mëshirës. Jo thjesht pse përpiquej t'u servilosej partizanëve, (e me këtë të lante një gabim të shkuar), por sepse në radhë të parë fati, filxhani, e kishte mësuar të mos tregohej i mëshirshëm ndaj të tjerëve. (Pak hoqi prej Hafëz Salepit?) Arsyeja e dytë ishte ca më e thjeshtë: ai i shërbente një regjimi, një administrate. Dhe për Panush Dhimën s'kishte rëndësi se kujt administrate i shërbente. Ai ishte një nëpunës i thjeshtë, i rëndomtë, që do t'i shërbente me të njëjtin zell edhe djallit, edhe Krishtit. Edhe këtë mësim filxhani ia kishte dhënë.

Kur u krijua kooperativa bujqësore, Panush Dhima i fali tërë ullinjtë dhe vreshtat. Jo se s'i dhimbeshin, por se s'kishte ç'humbiste. Puna e tij si kryellogaritar i kooperativës së shitblerjes i siguronte mjaft të ardhura. Nga rroga e mirë

nuk prishte më tepër se çerekun, sepse, duke shkuar fshat më fshat për verifikime apo inventare, veç drekave e darkave, merrte me vete edhe një pjesë të mirë të zahireve.

Vazhdonte të bënte një jetë të mbyllur. S'puqej me kërrkënd, a thua se u ruhej bashkëfshatarëve si djalli temjanit. I vetmi shok, motër, kushërirë, e parë, babë e nënë, ishte Malia, e veja e Jani Panos, shokut të ngushtë të fëmijnisë së Panushit. Ajo e lante, i gatuante, i seliste pjergullën. Panushi qe mësuar me të dhe vetëm asaj i besonte, i zbulonte çdo skutë të shpirtit. Bashkë e shihnin edhe filxhanin, por duhet thënë se Malia e konsideronte këtë një pallavër të madhe. Ajo kishte përmbysur qindra filxhanë, kishte ndezur qindra qirinj nën ikonën e shën Mërisë, po zoti e fati s'ia kishin lënë Janin, e patën degdisur në mbretërinë e goftëlargut.

5.

Vitet kalonin. Panushi ishte rrëgjuar e kërrusur si një hardhi shterpë. Tani edhe tek Edit Piafi rrallë e më rrallë i shkonte mendja. Dhe kjo për arsyen e thjeshtë se vyshkja e trupit shoqërohej edhe nga vyshkja e dëshirave dhe epshëve. E ndiente se po i vinte fundi, pavarësisht se filxhani nuk e parathoshte këtë. Po ç'rëndësi kishte filxhani? Panush Dhima atij filxhani